



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 16.12.2019

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.97, DATË 4.3.2013, “PËR MEDIAT AUDIOVIZIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjet e datave 22.11.2019, 25.11.2019, 6.12.2019, 11.12.2019 dhe 16.12.2019 mori në shqyrtim projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, nismë e Këshillit të Ministrave.

Bashkërelatore për shqyrtimin e këtij projektligji komisioni caktoi deputetet: znj. Vasilika Hysi dhe znj. Klotilda Bushka.

Në mbledhjet e komisionit, për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të komisionit, ishin të pranishëm: zëvendësministria e Drejtësisë, znj. Fjoralba Caka, përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, kryetari i Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), z. Gentian Sala dhe përfaqësues nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 81, pika 1 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHET TË ARRIHEN

Projektligji i propozuar përmban shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Sipas relacionit që shoqëron projektligjin, ky i fundit synon rregullimin e veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike (OSHPE), me qëllim garantimin e së drejtës së informimit, lirisë së shprehjes, mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave themelore të njeriut, respektimin dhe garantimin e së drejtës së jetës private, moslejimin e transmetimeve që nxisin intolerancë, gjuhë urrejtje dhe dhunë në shoqëri.

Rregullimi i veprimtarisë së portaleve online përmes një kornize ligjore, synon arritjen e një ekuilibri ndërmjet qasjes në shërbimet e përmbajtjes online, mbrojtjen e konsumatorit dhe konkurrencës, garantimin e të drejtave të njeriut, respektimin e të drejtave të autorit, për sa kohë këto shërbime përdorin vepra që i nënshtrohen të drejtës së autorit, si dhe arritjen e një gazetarie profesionale, të lirë dhe të pavarur.

Projektligji shoqërohet me raportin e vlerësimit të ndikimit të tij në shoqëri. Sipas këtij raporti¹, objektivat kryesore që synohen të arrihen mes rregullimeve janë si më poshtë:

- 1) Të normohet veprimtaria e shërbimeve të publikimeve elektronike;
- 2) Të garantohet e drejta e informimit dhe e lirisë së shprehjes, mbrojtja e të cilave garantohet prej konventave ndërkombëtare si dhe legjislacionit tonë të brendshëm;
- 3) Të mbrohet dinjiteti dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;
- 4) Të respektohet dhe garantohet e drejta e ruajtjes së jetës private;
- 5) Të mos lejohen publikimet që nxisin dhunën, gjuhën e urrejtjes, lajmet e rreme;
- 6) Të respektohet dhe mbrohet e drejta e autorit,

III. NEVOJA PËR NDËRRHYRJE LIGJORE DHE BAZA LIGJORE

Nevoja për një rregullim të veprimtarisë së mediave online është çështje që po diskutohet gjerësisht në të gjitha vendet e Evropës dhe në Shqipëri. Përdorimi gjithnjë dhe më gjerë dhe i shpejtë i medias online ka nxjerrë në pah një sërë problemesh edhe në vende me demokraci të konsoliduara.

Në rastin e Shqipërisë, mediat online kanë njohur një zhvillim të vullshëm. Krahas rritjes së përdorimit të tyre, është rritur edhe kujdesi për ta rregulluar dhe vetërregulluar atë. Janë kryer studime në lidhjen me median online, standardet e funksionimit të saj dhe rreziqet që paraqet kjo media në perceptimin e publikut dhe për median në tërësi, ndikimin në funksionimin e demokracisë, në kohezionin social, sigurinë dhe paqen në vend, rajon dhe më gjerë.

Sipas një studimi të kryer në Shqipëri në lidhje me mediat online, theksohet se: “*Fakti që nuk ka rregulla ligjore të detyrueshme për mediat online në krahasim me mediat audiovizive, do të thotë se nuk ka kufij specifikë të përcaktuar në aspektin e profesionalizmit dhe etikës. Anonimiteti, një tipar i pandarë i internetit dhe rrjedhimisht i medias online,*

<https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20190715110745Raporti%20i%20Vleresimit%20te%20Ndikimit%20AMA.pdf>

vendos një ton të ri dhe potencial për abuzim në mediat online në krahasim me mediat tradicionale, ku publiku zakonisht e lidh përmbajtjen me fytyrë dhe emër”².

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) në Rekomandimin nr. 15³ të tij të titulluar “Mbi luftimin e fjalimeve të urrejtjes” ka theksuar se: “përdorimi i gjuhës së urrejtjes duket se po rritet, veçanërisht përmes formave elektronike të komunikimit që zmadhojnë ndikimin e tij, por që masa e saktë e tij mbetet e paqartë për shkak të mungesës së raportimit sistematik dhe mbledhjes së të dhënave për ndodhjen e saj...;

Në Shqipëri liria e shprehjes dhe liria e medias mbrohet dhe garantohet me ligj. Krahas standardeve të parashikuara në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile, Politike dhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, legjislacioni i brendshëm ka sanksionuar lirinë e shprehjes dhe të medias.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Neni 18

1. Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim prej tij, si dhe lirinë për të manifestuar fenë apo besimin e vet, qoftë individualisht apo së bashku me të tjerët, si publikisht ashtu edhe privatisht, nëpërmjet kultit dhe kryerjes së riteve, praktikave dhe arsimit.
2. Askush nuk duhet t'i nënshtrohet ndonjë shtrëngimi që do të mund të prekte lirinë e tij për të pasur ose për të adoptuar një fe ose një besim të zgjedhur prej tij.
3. Liria e manifestimit të fesë apo të besimit të vet mund të bëhet objekt vetëm i kufizimeve të parapara me ligj dhe që janë të domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë, të rendit e të shëndetit publik, ose të moralit apo të lirive dhe të drejtave themelore të të tjerëve.
4. Shtetet palë të këtij Pakti zotohen të respektojnë lirinë e prindërve dhe, kur është e zbatueshme, të kujdestarëve të ligjshëm për të siguruar edukimin fetar dhe moral të fëmijëve të tyre në përputhje me bindjet e tyre.

Neni 19

1. Secili duhet të ketë të drejtën e opinionit pa ndonjë ndërhyrje.
2. Secili duhet të ketë të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacioneve dhe ideve të të gjitha llojeve, pavarësisht nga kufijtë, qoftë me gojë, me shkrim, në formë të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur prej tij.
3. Ushtrimi i lirive të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, nënkupton detyra dhe përgjegjësi të posaçme. Për rrjedhojë ai mund t'u nënshtrohet disa kufizimeve të cilat duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj dhe të jenë të domosdoshme:
(a) Për respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve;
(b) Për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.

Neni 20

1. Çdo propagandë në favor të luftës ndalohej me ligj.

² Për më shumë shih: “Peizazh i medias online në Shqipëri”, anketë me median online, botim i Institutit Shqiptar të Medias, Tiranë, 2018, f.15. Ky raport gjendet në internet në adresën: http://www.osfa.al/sites/default/files/peizazh_i_medias_online.pdf

³ ECRI General Policy Recommendation no. 15 “On combating hate speech” miratuar më 8 Dhjetor 2015, fq.4.Për më shumë shih: <https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-15-on-combating-hate-speech/16808b5b01>

2. Çdo thirrje për urrejtje kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitjen për diskriminim, armiqësi dhe dhunë ndalohet me ligj.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

NENI 10 Liria e shprehjes

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me liçencë.
2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

NENI 14 Ndalimi i diskriminimit

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 17

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.
2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

Neni 22

1. Liria e shprehjes është e garantuar.
2. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar.
3. Censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohet.

4. Ligji mund të kërkojë dhënien e autorizimit për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit.

Neni 23

1. E drejta e informimit është e garantuar.
2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.
3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

Ligji për shtypin sanksion se shtypi është i lirë. Ndërsa kuadri ligjor ekzistues që rregullon veprimtarinë e mediave audio/audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre është ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Në momentin e miratimit të ligjit për mediat audiovizive në vitin 2013, roli i teknologjisë dhe internetit në përhapjen e informacionit nuk ishte në dimensionet që ka arritur sot informimi nëpërmjet portaleve online. Në ditët e sotme janë zhvilluar vrullshëm shërbimet e ofruara përmes internetit e për rrjedhojë ka ndryshuar thellësisht mënyra e marrjes së informacionit. Është rritur akses i çdo individ për përdorimin e portaleve online e për pasojë është rritur shkalla e ndërveprimit dhe e shkëmbimit të informacionit. Nga ana tjetër, fenomeni i përhapjes në kohë reale të lajmeve të rreme dhe ndikimi negativ që ka dizinformimi tek besueshmëria dhe pavarësia e gazetarisë profesionale, tek vlerat demokratike dhe të drejtat e njeriut, është bërë shqetësuese dhe problematike.

Kuadri ligjor në fuqi nuk parashikon rregullime për veprimtarinë e kësaj kategorie ofruesish mediatikë të cilët përdorin internetin si mjet për zhvillimin e aktivitetit të tyre. Sipas relacionit që shoqëron projektligjin, ndërhyrja legjislative është bërë e nevojshme me qëllim mbrojtjen e individëve prej dizinformimit, për rritjen e cilësisë profesionale të gazetarisë, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut prej përmbajtjeve të papërshtatshme. Projektligji parashikon:

- a) Rregulla të qarta substanciale dhe procedurale për ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike (OSHPE) për të parandaluar cënimin e dinjitetit dhe reputacionit të individëve, parandalimin e ekspozimit të të miturve nga përmbajtjet e dëmshme si dhe parandalimin e ekspozimit të të gjithë qytetarëve nga nxitja e urrejtjes, dhunës etj;
- b) Rregulla të qarta procedurale për sigurimin e një mbrojtjeje efikase të të drejtave të personave fizikë dhe juridikë, publikë dhe privatë, nëpërmjet një mjeti procedural administrativ, të shpejtë dhe efikas, i cili synon si ndërgjegjësimin/ndalimin e përhapjes së informacionit të rremë/të pasaktë/tendencioz ashtu edhe marrjen e një mase të shpejtë në favor të mbrojtjes së të drejtave. Kjo masë është e ndryshme dhe nuk konkurren masat e parashikuara nga kuadri ligjor penal dhe civil;
- c) Respektim të lirisë së shprehjes dhe pluralizmit të tregut të medias elektronike;
- d) Rregulla që sigurojnë vendosjen e standardeve etike në mënyrë që të përmirësohet cilësia e informimit dhe e diskursit publik, si të ofruesve të shërbimit audiovizual ashtu edhe elektronik;
- e) Harmonizim të rregullave ku bazohet veprimtaria e ofruesve të shërbimeve elektronike (OSHPE) njësoj si ofruesit e shërbimeve audiovizuale (OSHMA);
- f) Rregulla të qarta për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtat e lidhura me to, nga ofruesit e shërbimeve të mediave elektronike (OSHPE dhe OSHMA).

Raporti i vlerësimit të ndikimit që shoqëron projektin ligjin vë në pah disa ndikime të tij në komunitet, te ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike dhe të organet që ligji i ngarkon me mbikëqyerjen e zbatimit të ligjit. Projektligji pritet të sjellë sidomos ndikime sociale: një rregullim të peisazhit mediatik, rritjen e nivelit të përgjegjshmërisë dhe profesionalizimit lidhur me përmbajtjen e publikuar, e munguar deri më tani, informin objektiv dhe me fakte, ulje të rasteve të dezinformimit si dhe do të ndikojë në mënyrë pozitive në nxitjen e punësimit dhe parandalimit të informalitetit në rradhët e gazetarëve⁴.

Ndryshimet në projektligj pritet të sjellin ndikim në mbrojtjen e disa kategorive shoqërore si mbrojtja e të miturve nga pornografia online, grupet që shpesh janë objekt i gjuhës së urrejtjes, racizmit, homofobisë, diskriminimit, si dhe do të ndalohen reklammat për lojrat e fatit dhe heqja e çdo mundësie për promovimin e lojrave të basteve në median online.

Sipas raportit që shoqëron projektligjin, ky i fundit pritet të sjellë ndikime të drejtpërdrejta të karakterit financiar për ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike, si rezultat i kërkesës për të punësuar një ose disa persona përgjegjës të publikimeve elektronike.

IV. PËRMBAJTJA DHE RISITË QË SJELL PROJEKTLIGJI

Projektligji synon përcaktimin e disa rregullave dhe vendosjen e disa standardeve etike në mënyrë që të respektohen dinjiteti dhe të drejtat themelore të njeriut, si dhe të përmirësohet cilësia e informimit dhe e të folurit publik. Konkretisht, projektligji si pjesë e paketës së dy projektligjeve konsiston në disa risi që paraqiten në vijim.

➤ Një legjislacion të plotë mbi shërbimet mediatike në Republikën e Shqipërisë.

Deri më sot mediat online nuk kanë një rregullim të tyre. Projektligji përcakton disa rregulla bazë dhe ndërkohë nxit median online të vetërregullohet dhe të zbatojë Kodin e Etikës.

➤ Procedura të shpejta administrative për trajtimin e ankesave nga persona të ndryshëm për programet e publikuara nga ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike (referuar në vijim “OSHPE”).

Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të shtetasve nga shkeljet e kryera nga ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike përbën një risi në projektligj. Projektligji në dy nene të reja parashikon procedurat e bërjes së kërkesës dhe shqyrtimit të saj si dhe detyrimet që ka ofruesi i shërbimeve të publikimeve elektronike për të dhënë përgjigje brenda një afati të përcaktuar në ligj në lidhje me kërkesën, detyrimin për të publikuar përgjigjen në një afat të njëten faqe ku është publikuar materiali që kontestohet, pa pagesë dhe nëse publikimi hiqet nga faqja/portali përpara se përgjigjja e personit të prekur/përmendur të publikohet, përgjigjja duhet të jetë e vendosur në një pozicion të krahasueshëm dhe për të njëjtën kohëzgjatje si publikimi i mëparshëm. Ky rregullim është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Kodin e Etikës së Gazetarëve.

Projektligji parashikon disa raste të refuzimit të trajtimit të një ankese nga Këshilli. Në projektligj është treguar kujdes në rastet kur: përmbushja e së drejtës për përgjigje përfshin

⁴ Sipas studimeve të kryera në vendin tonë, niveli i informalitetit në media është i lartë, pavarësisht se vitet e fundit ka pasur përmirësime. Për më shumë mund të lexoni: *Lorena ZAJMI, Laura PETRAK, Lutfi DERVISHI*, “Panorama e Medias në Shqipëri” botim i Institutit për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (IDRA), Shqipëri, Tiranë, 2019.

një ndëshkim, kapërcen rregullat e mirësjelljes apo sjell dënimin e ofruesit të shërbimit mediatik në një proces gjyqësor civil; përmbajtja e publikimit të kundërshtuar përmban thënie ose deklaramë të personit të prekur, që konsiderohen të barasvlershme me vetë përgjigjen e kërkuar ose kur personi ka dhënë pëlqimin paraprak në një mënyrë formale lidhur me përmbajtjen e publikimit; çështja objekt ankese lidhet me thëniet gjatë veprimtarive parlamentare, zhvillimit të seancave gjyqësore ose transmetimit të veprimtarive të subjekteve politike.

Me këto parashikime, është mbajtur parasysh standardi i lirisë së medias në demokraci sipas të cilit liria për të kritikuar zyrtarët qeveritarë është e garantuar⁵. Gjithashtu, projektligji parashikon që kundër vendimit të AMA-s bëhet ankimim në Gjykatën Administrative, Tiranë.

➤ **Regjistrimi i ofruesve të shërbimit të publikimeve elektronike**

Një nga risitë e projektligjit është krijimi i një regjistri të ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike (OSHPE) që administrohet nga AMA. Ky regjistër përmban të dhënat për OSHPE- të e pajisur me numër të regjistrimit të personit të tatueshëm, ose të regjistruar në regjistrat tregtarë të RSH-së.

Krijimi i regjistrit u jep mundësinë ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike të identifikohen për publikun në të gjithë elementët e tyre si dhe të përfitojnë lehtësira fiskale për faktin e përmbushjes vullnetarisht të këtij kriteri. Gjatë konsultimit të grupit të punës dhe bazuar në rekomandimin e ekspertëve të OSBE-së, regjistrimi i OSHPE nuk është i detyrueshëm.

➤ **Ofruesit e shërbimeve mediatike janë subjekte të kësaj pakete dhe monitorohen nga Autoriteti i Mediave Shqiptare (referuar si “AMA”, Albania Media Authority) me përjashtim të shtypit të shkruar. Projektligji parashikon të drejta dhe detyrime të njëjta për të gjitha mediat elektronike si audiovizive dhe elektronike (referuar “OSHMA” dhe “OSHPE”).**

Projektligji zgjeron fushën e zbatimit të ligjit për median audiovizive duke përfshirë të gjithë ofruesit e shërbimeve mediatike, pra edhe ofruesit e shërbimeve të medias elektronike. Ligji në fuqi “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” do të titullohet “Për shërbimet e medias në Republikën e Shqipërisë”.

Projektligji përmban përkufizimin e kuptimit “ofruesi i shërbimit të publikimeve elektronike (OSHPE)” i cili është personi fizik ose juridik, pavarësisht nëse është i regjistruar ose jo si i tillë në Regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve Mediatike, i cili ofron shërbimet e publikimeve elektronike.

Në projektligj përkufizohet edhe togfjalëshi “publikime elektronike” sipas të cilit nënkuptohet faqe e internetit me përmbajtje të formësuar editoriale dhe/ose portale që përmbajnë versione elektronike të medias së shkruar dhe/ose informacione mediatike të ofruara për publikun, me qëllim argëtimin, informimin dhe edukimin. Publikimet elektronike të bëra nga individë, të cilat nuk kanë përmbajtje të formësuar editoriale dhe nuk kanë qëllim

⁵ Sipas treguesve të Këshillit të Evropës mbi mediat në Demokraci, ligji nuk duhet të mbrojë zyrtarët shtetërorë nga kritikë dhe ofendimet në një masë më të madhe se qytetarët e zakonshëm. Për më shumë shih: Media shqiptare dhe standardet evropiane, Raport i bazuar mbi Treguesit e Këshillit të Evropës mbi Median në Demokraci, Studim i Institutit Shqiptar të Medias, Tiranë 2018, f.16.

edukimin, argëtimin, apo informimin për publikun, nuk konsiderohen publikime elektronike në kuptim të këtij ligji.

Ashtu si OSHMA-të edhe OSHPE-të gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen nga të njëjtat parime ku vlen të përmenden: garantimi i lirisë së shprehjes; garantimi i së drejtës së informimit; ruajtja e sekretit të burimeve të informacionit; respektimi dhe garantimi i së drejtës së ruajtjes së jetës private; moslejimi i transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve; moslejimi i transmetimeve që nxisin ose justifikojnë dhunën; garantimi i së drejtës së përgjigjes; garantimi i së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të; respektimi i fqinjësisë së mirë midis popujve; respektimi i standardit letrar të gjuhës shqipe etj. Projektligji parashikon mbikëqyrje të unifikuar për OSHMA-të edhe për OSHPE-të nga organet e AMA-s (*Këshilli i Ankesave dhe Bordi*).

➤ **Parashikohen të drejta dhe detyrime të qarta, jo vetëm për ofruesit e shërbimeve të mediave audiovizive, por edhe për ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike.**

Projektligji parashikon që ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike të sigurojnë që publikimet të shfaqen në një mënyrë të vërtetë, të paanshme dhe objektive; që trajtimi i ngjarjeve, përfshirë çështjet që janë tema të debatit publik, të jetë i drejtë për të gjithë subjektet e interesuara në këto çështje dhe të paraqitet në mënyrë të vërtetë dhe të paanshme; të vendosin masa mbrojtëse për mospërdorimin e tyre për qëllime kriminale; të mos çenojnë dinjitetin dhe të drejtat themelore të njeriut; të ofrohet akses i njëjtë për të gjithë përdoruesit, pa dallime ndërmjet sekseve, racave, etnisë apo besimit fetare; të mos çenojnë sigurinë kombëtare dhe sigurinë e publikut; të mos çenojnë shëndetin publik; të respektojnë rregullat e etikës dhe moralit publik dhe të mos lejojnë shfaqjen e publikimeve që mund të nxisin vepra penale; të respektojnë të drejtat e autorit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të; të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit.

Ata duhet të publikojnë në mënyrë të qartë dhe të dallueshme informacionin për: a) emrin dhe adresën, e në rastin e personave juridikë, emrin dhe adresën e përfaqësuesit të autorizuar; b) shenjë/dritaren ku mund të bëhet ankesë për lajmin e publikuar; c) emrin dhe adresën e personit/personave përgjegjës të caktuar për sektorin/sectorët përkatës të publikimeve, të cilat duhet të publikohen qartësisht.

➤ **Mbrojtja e individëve nga lajmet e rreme dhe dizinformimi**

Studimet⁶ kanë treguar se Shqipëria renditet ndër vendet e fundit të Evropës që është e përgatitur për t'u përballuar me lajmet e rreme. Nga ana tjetër, një studim tjetër⁷ vë në pah

⁶ Sipas studimit të kryer Instituti Shqiptar i Medias, në vitin 2018, "Indeksi i Aftësisimit për Median 2018 e renditi Shqipërinë ndër vendet e fundit në Europë në lidhje me gatishmërinë për t'u përballur me epokën e lajmeve të rreme, vetëm përpara Turqisë dhe Maqedonisë që renditeshin të fundit. Në një kohë kur mediat online po shtohen çdo ditë dhe aksesit është më i lehtë, duket se edhe përgatitja e popullatës për të filtruar dhe kritikuar siç duhet këto media është mjaft e ulët. Për më shumë shih; "Peizazh i medias online në Shqipëri", Anketë me median online, Botim i Institutit Shqiptar të Medias, Tiranë, 2018, f.15. Ky raport gjendet në internet në adresën: http://www.osfa.al/sites/default/files/peizash_i_medias_online.pdf

⁷ Shkeljet e Etikës në Media, Studim i Këshillit Shqiptar të Medias, Tiranë 2019. Sipas studimit rezulton se në Shqipëri operojnë mbi 700 media, shumica e tyre (rreth 650) janë media që operojnë ekskluzivisht online dhe se opinioni publik bombardohet përditë nga një larmi gati e pakonfirmueshme informacioni". Po në këtë studim theksohet se gjatë periudhës së monitorimit: gusht 2018 – janar 2019, nga rreth 40 portale dhe faqe online

numrin e lartë të mediave, shumica e të cilave janë online dhe që shpërdajnë informacion të pakonfirmuar dhe që numri i shkeljeve të kryera është i përhapur dhe i lartë.

Çdo individ, i cili çenohet nga publikimi i përmbajtjeve të paligjshme, ose të pavërteta, tashmë nëpërmjet këtyre ndryshimeve ka mundësi të rivendosë të drejtën e tij në vend. Nga ana tjetër, ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike do të kenë mundësinë të vënë ata të parët të drejtën në vend duke reaguar në kohë për të gjitha sinjalizimet se publikimet e tyre kanë qenë të pavërteta ose në çenim të të drejtave të individit. Sikurse është theksuar edhe më lart, në projektligj parashikohen rregulla për trajtimin e ankesave në rrugë administrative dhe ndaj vendimeve që marrin organet e përkatëse, mund të ushtrohet ankim në gjykatë. E drejta për ankim në gjykatë është propozuar nga grupi i punës, bazuar në rekomandimin e adresuar nga ekspertët e OSBE-së, ndonëse është një rregull i përgjithshëm i procesit të rregullt ligjor.

➤ **Mbrojtja e të miturve në publikimet online**

Paketa synon një mbrojtje të veçantë për fëmijët në rastet kur publikimet dhe transmetimet e shërbimeve mediatike janë të paligjshme, duke parashikuar mekanizma mbrojtës për fëmijët nën moshën 18 vjeç. Deri më sot, mbrojtja e të miturve në mediat online nuk ka qenë e rregulluar. Ligji në fuqi “Për mediat audiovizitive në Republikën e Shqipërisë” përmban disa rregulla të përgjithshme në lidhje me komunikimet me qëllime tregtare në transmetimet audiovizive, konkretisht në nenin 42 të tij, konkretisht pika 5 dhe 8.

Projektligji, duke përcaktuar detyrimet e ofruesit e shërbimit të publikimeve elektronike ndaj publikut për të bërë të lehtë aksesin e këtij të fundit, parashikon një rregull të ri (neni 33/1) për mbrojtjen e fëmijëve. Sipas propozimit, një ofrues i shërbimit të publikimeve elektronike duhet të publikojë paralajmërim të përshtatshëm për përmbajtjen e publikimeve, të cilat mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, shëndetësor, moral, mendor, intelektual, emocional dhe social të të miturve.

Në zbatim të standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nën moshën 18 vjeç, projektligji parashikon ndalimin e publikimit të informacionit që zbulon identitetin e të miturit nën moshën 18 vjeç, i përfshirë në çdo rast të dhunës, pavarësisht nëse i mituri është dëshmitar, viktimë, ose shkelës i ligjit, si dhe ndalon zbulimin e ndonjë veçantie të marrëdhënieve familjare dhe jetës private të një fëmije.

➤ **Parandalimi dhe ndalimi i gjuhës së urrejtjes në mediat online**

Bazuar në standardet ndërkombëtare në lidhje me parandalimin e gjuhës së urrejtjes, deri më sot ligjvënësia ka treguar kujdes për të bërë rregullime në Kodin Penal për dënimin e krimeve të urrejtjes në çdo formë që kryhen, përfshirë edhe përmes sistemit kompjuterik dhe formave të tjera të komunikimit.

Ligji për mediat audiovizive ndalon komunikimet me natyrë tregtare që të përfshijnë ose të mbështesin diskriminimin në bazë seks, race ose origjine etnike, kombësie, moshe,

mediesh të monitoruara, numri i përgjithshëm i mediave ku rezultuan shkelje ishin 35, ndërsa numri i përgjithshëm i shkeljeve të monitoruara ishte 1.280. Shkeljet kishin një tendencë rritje nga muaji në muaj.

besimi, feje, paaftësie ose orientimi seksual (neni 42, pika 3, shkronja “b”), por nuk rregullon parandalimin e gjuhës së urrejtjes në mediat online.

Rekomandimet e Komisionit Evropian kundër Intolerancës dhe Racizmit (ECRI), konkretisht rekomandimi nr. 7 “Mbi legjislacionin kombëtar për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racia” miratuar më 13 dhjetor 2002 dhe amenduar më 7 dhjetor 2017 dhe Rekomandimi nr. 15 “Lufta kundër fjalimit të urrejtjes”, miratuar në Dhjetor 2015 sanksionojnë detyrimin e shteteve për të marrë masa ligjore, civile, administrative dhe penale për të luftuar gjuhën dhe krimet e urrejtjes. Në këto rekomandime, theksi vihet te masat civile dhe administrative për parandalimin e gjuhës së urrejtjes dhe masat penale të shihen si mjeti i fundit, kur fjala është për gjuhën e urrejtjes.

Rekomandimi 15 I ECRI –it sanksion:

- a) nevojën e qartësimit të përgjegjësisë sipas ligjit civil dhe administrativ për përdorimin e gjuhës së urrejtjes, duke respektuar të drejtën e lirisë së shprehjes dhe mendimit,
- b) duke përcaktuar përgjegjësitë e veçanta të autorëve të gjuhës së urrejtjes, ofruesve të shërbimit të internetit, forumeve dhe organizatorëve në internet, ndërmjetësve në internet, platformave të mediave sociale, moderatorëve të faqeve personale dhe të tjerëve që kryejnë role të ngjashme;
- c) siguruar mundësinë e disponueshmërisë së kompetencave, në varësi të autorizimit ose miratimit gjyqësor, për të kërkuar fshirjen e gjuhës së urrejtjes nga materiali i arritshëm në internet, për të bllokuar faqet që përdorin gjuhën e urrejtjes, për të ndaluar shpërndarjen e gjuhës së urrejtjes dhe për të detyruar zbulimin e identitetit të atyre që e përdorin atë;
- d) siguruar mbështetje për ata që synohen nga fjalimi i urrejtjes⁸.

Projektligji përmban rregulla të përgjithshme në lidhje me detyrimin që ka ofruesi i shërbimit të publikimeve elektronike që të mos nxisë, të shtojë nxitjen ose të përhapë urrejtje ose diskriminim në bazë të racës, prejardhjes etnike, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare ose sociale, gjendjes financiare, arsimit, statusit social, gjendjes martesore ose familjare, moshës, gjendjes shëndetësore, paaftësisë, trashëgimisë gjenetike, identitetit gjinor ose orientimit seksual dhe të drejtën që ka viktimat që të kërkojë korrigjimin dhe të marrë përgjigje ndaj informacionit të publikuar, nëpërmjet një ofruesi të shërbimeve të publikimeve elektronike. Projektligji nuk rregullon në detaje procedurën, duke ia lënë këtë vetërregullimit që duhet të bëjë media.

➤ **Mbrojtja e të drejtës së autorit**

Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”. Një studim i kryer në Shqipëri mes anketimit të përfaqësuesve të vetë medias online ka nxjerrë si problem shkeljen e së drejtës së autorit, pasuar nga mungesa

⁸ ECRI General Policy Recommendation no. 15 “On combating hate speech” miratuar më 8 Dhjetor 2015, pika 7. Për më shumë shih: <https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-15-on-combating-hate-speech/16808b5b01>

e raportimit cilësor⁹. Projektligji adreson problemet që lidhen me të drejtën e autorit në transmetimet dhe ritrasmetimet, përfshirë edhe në median online.

➤ Vetërregullimi në media

Sipas treguesve të medias në Demokraci hartuar nga Këshilli i Evropës dhe analizës së respektimit të tyre në Shqipëri¹⁰, vetërregullimi i medias është i preferuar. Aktualisht ka përpjekje për të pasur dhe zbatuar Kodin e Etikës, por sikurse theksohet në studime ato përdoren shumë rrallë nga media.

Projektligji, duke rregulluar masat administrative, vlerëson nevojën e vetërregullimit. Në nenin 21 të ligjit ekzistues, pas shkronjës “dh”, të pikës 2, shtohen shkronjat “e” dhe “ë”, që kërkojnë nga AMA të marrë masa dhe veprime për të nxitur lirinë e medias në përputhje me rregullat dhe detyrimet etike dhe të nxisë vetërregullimin e medias.

➤ Masat për shkeljet e kryera

Projektligji parashikon disa lloje masash që mund të zbatohen nga organet në rastet e shkeljes së ligjit. Neni 132 i projektligjit është diskutuar gjërësisht gjatë procesit të konsultimit publik me ekspertët ndërkombëtarë, me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësues të medias. Në diskutimin dhe rishikimin e tij janë mbajtur parasysh treguesit e Këshillit të Evropës për Mediat në Demokraci, konkretisht “Gazetarët nuk duhet të dënohen me burg, dhe po ashtu organet e medias nuk duhet të mbyllen si pasojë e komenteve dhe opinionëve kritike”¹¹. Gjithashtu, riformulimi i përmbajtjes së këtij neni është bërë bazuar në sugjerimet e ekspertëve të OSBE –së.

Projektligji i diskutuar në komision parashikon masat e mëposhtme:

- a) Detyrimin e ofruesit të shërbimit të medias për të publikuar formulën e korrigjimit sipas formës dhe përmbajtjes së parashikuar në ligj;
- b) Detyrimin për të vendosur nëpërmjet AKEP-it një njoftim të karakterizuar teknikisht si “pop up”;
- c) për të vendosur gjobë, shuma e së cilës përcaktohet në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të tij;
- d) për të vendosur pezullim të përkohshëm të licencës dhe/ose autorizimit;
- e) për të vendosur uljen e kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës dhe/ose autorizimit;
- f) për të vendosur heqje të licencës dhe/ose autorizimit

Në rastet e ekspozimit të fëmijëve ndaj pornografisë në publikimet online, inkurajimin e akteve terroriste dhe shkelje të sigurisë kombëtare, heqja e publikut duhet të bëhet brenda 60 minutave dhe vetëm në rast të mosplotësimit të urdhërit brenda afatit të përcaktuar, AKEP bllokoi aksesin në internet.

⁹ Peizazh i medias online në Shqipëri”, vep e cituar, f.26.

¹⁰ Media shqiptare dhe standardet evropiane. Raport i bazuar mbi Treguesit e Këshillit të Evropës mbi Median në Demokraci, Studim i Institutit Shqiptar të Medias, Tiranë 2018. Në studim theksohet se “Procesi i vetërregullimit të profesionit të gazetarisë në Shqipëri është shumë larg standardeve ndërkombëtare të mbrojtjes të lirive dhe të drejtave të gazetarëve. Megjithatë ekziston Kodi i Etikës, si dhe kode apo rregullore të tjera profesionale, zbatimi i tyre në praktikë lihet në dorë të gazetarëve dhe ndërgjegjes së tyre. Ka patur disa përpjekje gjatë këtyre 25 vjetëve për të krijuar instrumente vetërregulluese por ato nuk kanë patur sukses”. Ky studim gjendet i botuar në adresën:

<http://www.institutemedia.org/Documents/PDF/Media%20shqiptare%20dhe%20standartet%20evropiane.pdf>

¹¹ Po aty, faqe 16.

Projektligji parashikon që në marrjen e vendimit në rastet e sipërcituara AMA dëgjon ofruesin e shërbimit të publikimeve elektronike dhe nëse është e mundur autorin e përmbajtjes së publikuar, vlerëson shkeljen e kryer duke mbajtur parasysh raportin mes së drejtës së lirisë së shprehjes dhe cënimit të saj dhe vendos në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Projektligji parashikon si masë ndaj shkeljes vendosjen e një njoftimi “*pop up*” në faqen e internetit/domain-in e portalit i cili përmban informacion mbi vendimet e organeve vendimmarrëse të AMA-s.

Gjithashtu, projektligji parashikon kontrollin gjyqësor ndaj vendimeve të AMA-s. Kundër vendimit të AMA-s dhe Këshillit të Ankesave mund të bëhet ankim në Gjykatën e Administrative Tiranë.

➤ **Shkeljet disiplinore dhe gjobat**

Gjobat i referohen vetëm mosveprimit procedural të OSHPE-ve për të reaguar në kohë dhe për t’i dhënë mundësi subjekteve të japin versionin e tyre të së vërtetës. Përmbajtja e përgjigjes nuk u imponohet as nga ligji e as nga AMA. Nëse OSHPE-të u sigurojnë të drejtat procedurale individëve ankues, asnjë gjobë nuk aplikohet ndaj tyre.

AMA mbetet përherë një autoritet i pavaruar, e cila aktualisht ka funksione që lidhen vetëm me subjektet që ofrojnë shërbime mediatike audio dhe audiovizive. Nëpërmjet këtij projektligji funksionet e saj shtrihen edhe për publikimet elektronike, e konkretisht vetëm për subjekte të parashikuara në përkufizimin e qartë të projektigjit.

Vendimet e AMA-s nuk zëvendësojnë gjykatën, e cila mbetet jo vetëm garancia procedurale e shkallës së ankimit ndaj vendimit administrativ të organeve të AMA-s, por gjykata dhe vetëm gjykata shqyrton çështjet ku ngrihen problemet e shpifjes.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*referuar në vijim “AKEP”*) në bazë të vendimit të AMA-s dhe pas marrjes së mendimit të organeve të specializuara të fushës mund të vendosë bllokim aksesit të përkohshëm për ofruesit e shërbimeve mediatike elektronike, vetëm në rastet ekstreme të veprimeve kriminale si: pornografia me të mitur, nxitja e akteve terroriste dhe cënimi i sigurisë kombëtare.

➤ **Ndalimi i reklamave për lojërat e fatit, bastet sportive, kazinotë dhe bingo televizive**

Ndryshimet e propozuara në projektligj adresojnë edhe ndalimin e reklamave për lojërat e fatit, bastet sportive, kazinotë dhe bingo televizive. Në nenin 42 të ligjit “Komunikimet me natyrë tregtare” shtohet një pikë e re 6/1 që sanksion se të gjitha format e komunikimeve me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive dhe publikimet elektronike për lojërat e fatit, bastet sportive, kazinotë dhe bingo televizive, janë të ndaluara.” Ky ndryshim lind si nevojë e reflektimit të ndryshimeve të bëra në ligjin “Për lojërat e fatit” së fundmi.

V. TRANSPARENCA DHE KONSULTIMI PUBLIK

Projektligji iu nënshtrua një procesi të gjatë të konsultimit publik. Ai është konsultuar në vazhdimësi me ekspertët ndërkombëtarë të OSBE-së dhe është rishikuar disa herë nën dritën e komenteve dhe sugjerimeve të tyre edhe nga grupi i punës i përbërë nga relatorët e komisioneve “Për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut” dhe “Për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik” me asistencën e ekspertëve ndërkombëtarë.

Krahas konsultimit me ekspertët e OSBE-së, është zhvilluar një proces i gjerë konsultimi dhe në tryezat e konsultimit publik të zhvilluara nga Komisioni i Ligjeve sipas një kalendarit të posaçëm të miratuar në mbledhjen e datës 11.11.2019 për shqyrtimin e dy projektligjeve, konkretisht projektligji *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9918, datë 19.5.2008 dhe “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar*¹².

Bazuar në kalendarin e miratuar dhe në përputhje me parashikimet e nenit 36 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, Komisioni organizoi seancat dëgjimore si më poshtë:

Në datën 25.11.2019 Komisioni i Ligjeve zhvilloi seancë dëgjimore me përfaqësues të institucioneve shtetërore, partnerëve ndërkombëtarë. Në seancë dëgjimore në komision morën pjesë përfaqësues nga: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Prezenca e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, Avokati i Popullit, Delegacioni i Bashkimit Europian, Agjensia e Zhvillimit Ndërkombëtar (USAID), Prezenca e Këshillit të Europës, Prezenca e Bashkimit Europian për të personat që nuk dëgjojnë. Nga operatorët mediatikë nuk pati pjesëmarrje.

Në datën 10.12.2019 Komisioni i Ligjeve zhvilloi seancë dëgjimore me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Në këtë seancë morën pjesë përfaqësues nga: Exit Neës, Shoqata e Avokatëve Penalistë, Faktoje.al, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, National Democratic Institute (NDI), Res Publika, Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, Birn Albania. Nga dhomat e tregtisë dhe shoqatat e biznesit nuk pati pjesëmarrje.

Në datën 11.12.2019 Komisioni i Ligjeve zhvilloi seancë dëgjimore me përfaqësues të botës akademike, fushës së gjyqësorit, prokurorisë, avokatisë dhe shoqatave të mediave dhe gazetarëve. Morën pjesë përfaqësues nga: Prokuroria e Përgjithshme, Fakulteti i Drejtësisë, gazetarë/ë të “A2 CNN”, gazetarë/ë të “Report TV”, gazetarë/ë të “Panorama”.

Komentet e marra nga pjesëmarrësit si gjatë konsultimeve publike dhe kontributet me shkrim janë shqyrtuar dhe vlerësuar në mbledhjet e grupit të punës dhe një pjesë e tyre janë reflektuar në tekstin e projektligjit.

Rekomandimet e OSBE-së¹³, të dërguara përkatësisht gjatë muajve janar, korrik, tetor dhe nëntor 2019 janë shqyrtuar dhe vlerësuar në mbledhjet e grupit të punës dhe janë reflektuar plotësisht në tekstin e projektligjit. Disa nga rekomandimet e rëndësishme të OSBE-së, të reflektuara në projektligj janë:

- *Rekomandohet që në nenin që ndryshon nenin 3 të ligjit në fuqi të shtohet paragrafi 26/1 me këtë përmbajtje: “Publikimet elektronike të bëra nga individë, të cilat nuk kanë përmbajtje të formësuar editoriale dhe nuk kanë qëllim edukimin, argëtimin, apo informimin për publikun, nuk konsiderohen publikime elektronike në kuptim të këtij ligji.”. Shtimi i paragrafit rekomandohet me qëllim për të shmangur çdo zbatim të tepruar dhe abuziv të ligjit. Përkufizimi i publikimeve elektronike, duhet të përcaktohet saktë*

¹²<https://www.parlament.al/Files/ProgramiPunes/Kalendar%20seancat%20degjimore%20per%20paketen%20antishpifje%20FINAL.pdf>

¹³ <https://www.osce.org/fom/66082>

duke marrë parasysh nevojën për të qenë sa më preciz të jetë e mundur në këtë fushë të ndjeshme.

- *Rekomandohet heqja e pikës 55 të shtuar në nenin që ndryshon nenin 3 të ligjit në fuqi "media outlet", pasi kjo pikë përmban një përkufizim të përgjithshëm të "mediave", i cili përfshin kategori që nuk rregullohen me këtë projektligj, veçanërisht shtypin e shkruar.*
- *Rekomandohet që të hiqet paragrafi 2 i nenit 33/1, i propozuar për t'u shtuar pas nenit 33 të ligjit në fuqi, pasi përfshin dispozita dhe parime që janë të paqarta edhe në fushën e mbrojtjes së të drejtave e dinjitetit të njeriut si dhe të drejtave të të miturve.*
- *Rekomandohet që të hiqen referencat për "besimin politik" dhe "anëtarësimin në sindikatë" të përfshira në paragrafin 4 të nenit 33/1.*
- *Rekomandohet një dispozitë e përgjithshme në lidhje me të drejtën e ankimit para gjykatës kompetente për çdo vendim të marrë nga AMA.*
- *Rekomandohet heqja e pikës "ii", në paragrafin 1, të nenit që ndryshon nenin 132 të ligjit në fuqi, konkretisht "ii.heqja e përmbajtjes e cila shkel të drejtat". Heqja e përmbajtjes në internet është një masë jashtëzakonisht shtrënguese, e cila sipas standardeve ndërkombëtare, është e pranueshme vetëm në raste të jashtëzakonshme, kur interesi publik në fjalë tejkalon qartë të drejtën e një individi për lirinë e shprehjes. Përveç kësaj, çdo vendim që do të përfaqësonte heqjen e një faqe të tërë ose shërbimi do të ishte një kufizim joproporcional dhe për rrjedhojë i papranueshëm i së drejtës së lirisë së shprehjes në internet. Për këto arsye, dhe duke marrë parasysh që koncepti i "heqjes", për nga natyra e tij, vlen vetëm për përmbajtjen e postuar nga ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike, rekomandohet heqja e kësaj pike.*
- *Rekomandohet që të hiqet neni që parashikon shtimin e nenit 132/1 pas nenit 132 të ligjit në fuqi, duke marrë parasysh që të gjitha masat e mundshme në lidhje me përmbajtjen e paligjshme janë parashikuar në nenin 132.*
- *Rekomandohet ulja e kufirit minimal të gjobës në shkronjën "b", të pikës 2 të nenit që ndryshon nenin 133 të ligjit në fuqi.*
- *Rekomandohet ndryshimi i shkronjës "a" të pikës 5, të nenit që ndryshon nenin 132 të ligjit në fuqi. Duke marrë parasysh rolin e përgjithshëm dhe përgjegjësitë e AMA-s, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen e të drejtës së lirisë së shprehjes në Shqipëri, rekomandohet që ndërhyrja e AMA-s për të bllokuar menjëherë aksesin në internet të ndryshojë duke urdhëruar më parë heqjen e përmbajtjes së caktuar. Po kështu, në paragrafin 1.a) rekomandohet të zëvendësohet "formula e korrigjimit sipas formës dhe përmbajtjes së përcaktuar nga AMA" me "korrigjimin ose përgjigjen sipas parashikimeve të nenit 53/1 të këtij ligji".*

Rekomandimet e përfaqësuesve të BE-së të adresuara dhe reflektuara në projektligj janë si më poshtë:

- Rekomandohet saktësimi i përkufizimit të publikimit elektronik për të bërë dallimin e publikimeve me përmbajtje të formësuar editoriale dhe publikimeve që nuk kanë përmbajtje të formësuar editoriale. *Është pranuar ky rekomandim dhe është reflektuar në nenin 26/1.*
- Rekomandimi lidhur me saktësimin e detyrimit për regjistrim të ofruesve të shërbimit të publikimeve elektronike është pranuar dhe reflektuar në nenin 33/2 të projektligjit.

"Neni 33/2

Regjistrimi i ofruesve të shërbimit të publikimeve elektronike

Një person fizik a juridik, i cili ofron shërbime të publikimeve elektronike, ka të drejtë të aplikojë tek AMA për regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave të tij në Regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve Mediatike. Ky regjistrim nuk është parakusht për të ofruar shërbimin”.

Standardi i vendosur që botimet të trajtohen në mënyrë realiste, të paanshme dhe objektive, rekomandim i pranuar dhe reflektuar në nenin 4/1 të projektligjit.

*“Neni 4/1.
Interpretimi i ligjit*

1. *Dispozitat e këtij ligji nuk duhet të interpretohen në mënyrë të tillë që të japin të drejtën për të censuruar apo kufizuar të drejtën për lirinë e fjalës ose lirinë e shprehjes.*
 2. *Ky ligj interpretohet dhe zbatohet në përputhje me parimet e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, sikurse zbatohet në praktikën ligjore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*
- Standartet ndërkombëtare në fushën e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias janë thelbësore për zhvillimin e mediave të forta dhe pluraliste, rekomandim i pranuar dhe reflektuar në nenin 1.

*“Neni 1
Objekti*

Ky ligj rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave fizikë dhe juridikë, që ofrojnë shërbime audio, audiovizive dhe shërbime të publikimeve elektronike, nëpërmjet rrjetit të komunikimeve elektronike, si dhe promovimin e pluralizmit të medias dhe çështjeve të tjera me rëndësi për shërbimet mediatike, në përputhje me konventat dhe standartet ndërkombëtare.”.

Nga rekomandimet e Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, të pranuar dhe reflektuara në tekstin e projektligjit:

- Rekomandimi për forcimin e Këshillit të Ankesave dhe përfshirjen e aktorëve të fushës së medias së shkruar si dhe një sistem vetërregullimi i trajtimit të ankesave, *reflektuar në nenin që ndryshon nenin 20 të ligjit në fuqi. Propozohet që anëtarët e Këshillit të Ankesave të mos emërohen, por të zgjidhen mbi bazën e procedurave të konkurueshmërisë.*
- Bashkërregullimi përmes një gjykate të pavarur dhe aksesit në mjetet juridike, *rekomandim i reflektuar në pikën 10 të nenit 53/1 si dhe në pikën 6 të nenit 132.*

“10. Kundër vendimit të AMA-s bëhet ankim në Gjykatën Administrative, Tiranë”

“6. Kundër vendimit të bllokimit të aksesit në internet.....Kundër vendimit të AMA-s mund të bëhet ankim në Gjykatën e Administrative Tiranë.”

- Transparenca e pronësisë në treg si një aspekt jetësor për të siguruar një media të lirë dhe pluraliste, është një tjetër rekomandim i reflektuar në nenin 33/2 të projektligjit.

- Është reflektuar në pikën 5 të nenit 132 rekomandimi për heqjen e përmbajtjes kriminale të renditura në projektligj si: pornografi me fëmijë, inkurajim i akteve terroriste; shkelje e sigurisë kombëtare.

Është adresuar një nga **rekomandimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale** që në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit që ndryshon nenin 19 të ligjit në fuqi, *të shtohet në funksionet e AMA-s edhe bashkëpunimi dhe këshillimi me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.*

Shqetësimet e adresuara nga **shoqatat e mediave dhe shoqëria civile** dhe zgjidhjet e reflektuara në tekstin e projektligjit:

Shqetësimi se Këshilli i Ankesave mund të përdoret politikisht për të luftuar media të caktuara, *ka gjetur zgjidhje në ndryshimet e propozuara në nenin që ndryshon nenin 20 të ligjit në fuqi. Anëtarët e këtij këshilli propozohet që të mos emërohen, por të zgjidhen mbi bazën e procedurave të konkurueshmërisë.*

Pamundësia financiare dhe jo e njëjtë e ofruesve të shërbimit të medias elektronike është një tjetër shqetësim i cili gjen zgjidhje në një nga ndryshimet e propozuara nga grupi i punës që masat e gjobave të parashikuara në draft, të jenë proporcionale me buxhetin e televizioneve dhe portaleve.

Parashikimi ligjor se gjobat e AMA-s janë tituj ekzekutiv dhe ekzekutohen menjëherë pa pritur vendimin e formës së prerë të gjykatës, është një tjetër shqetësim i shoqatave të mediave.

VI. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA DHE NDRYSHIME TË MIRATUARA NË KOMISION

Komisioni e shqyrton projektligjin në aspektin e përputhshmërisë me nenin 10 dhe 14 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, protokollit 12 të kësaj Konvente, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë si dhe rezolutat dhe rekomandimet ndërkombëtare në fushën e medias dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Gjatë prezantimit të projektligjit në parim, nga relatorët u theksua nevoja për plotësimin e vakumit ligjor në fuqi për shërbimin e mediave elektronike, garantimin e së drejtës së informimit, të lirisë së shprehjes, mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të tjera themelore të njeriut, respektimin dhe garantimin e së drejtës së ruajtjes së jetës private, moslejimin e transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve, moslejimin e transmetimeve që nxisin ose justifikojnë dhunën etj.

Duke vlerësuar rëndësinë që ka rregullimi i medias online, relatorët vunë theksin në nevojën që ka vetërregullimi i medias, miratimi dhe zbatimi i Kodit të Sjelljes nga mediat online, rritja e profesionalizmit të gazetarëve, trajnimi i tyre, transparenca e pronarëve dhe financimit të medias online dhe parandalimi i përhapjes së lajmeve të rreme dhe dezinformimi.

Relatorja znj. Hysi, theksoi rritjen e shpejtë të përdorimit të medias online dhe rolin e shoqërisë civile, sidomos të organizatave që operojnë në fushën e medias dhe të të drejtave të gazetarëve përsa i përket botimeve dhe studimeve që kanë kryer këto vitet e fundit në lidhje me median online dhe standardet e saj.

Gjithashtu, relatorët vlerësuan dhe shprehën mirënjohjen për të gjithë institucionet, organizatat vendase dhe ndërkombëtare, gazetarë/e, për përfaqësues të botës akademike që shprehëm mendime dhe sugjerime me shkrim ose ishin të pranishëm në seancat e konsultimit publik të zhvilluar nga Komisioni i Ligjeve. Në cilësinë e relatoreve, ato vlerësuan dhe falenderuan në mënyrë të veçantë ekspertët e OSBE-së, Zyra Vjenë, përfaqësuesen e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe ekspertin e Këshillit të Europës dhe Prezencës së OSBE-së në Tiranë për mendimet dhe sugjerimet e ofruara për këtë projektligj.

Gjatë diskutimit nën për *nen të projektligjit*, relatorja znj. Bushka prezantoi përpara anëtarëve të komisionit draftin e ripunuar nga grupi i punës me asistencën e ekspertëve ndërkombëtarë. Ajo shpjegoi për anëtarët e komisionit dhe të pranishmit e tjerë se ku konsistojnë ndryshimet e propozuara në këtë draft dhe si janë reflektuar shqetësimet e adresuara nga partnerët ndërkombëtarë dhe shoqatat e mediave gjatë procesit të konsultimit të projektligjit.

Bazuar në reflektimet e grupit të punës, çështjet e adresuara gjatë seancës dëgjimore, mendimeve të ekspertëve ndërkombëtarë si dhe në diskutimet e zhvilluara në komision, komisioni miratoi projektligjin në parim dhe diskutoi dhe miratoi nën për nen ndryshimet e mëposhtme.

Neni 1 i projektligjit, që ndryshon titullin e ligjit, miratohet sipas propozimit të përcjellë nga Këshilli i Ministrave.

Neni 2 i projektligjit që ndryshon përmbajtjen e nenit 1 të ligjit e që rregullon objektin e ligjit miratohet sipas propozimit të përcjellë nga Këshilli i Ministrave.

Neni 3 i projektligjit që ndryshon nenin 2 të ligjit në fuqi është riformuluar nga grupi i punës dhe u miratua nga Komisioni i Ligjeve duke shtuar në fund të nenit fjalinë që saktëson se ky ligj nuk vepron për shtypin e shkruar pasi ky i fundit rregullohet me një ligj të veçantë.

Neni 4 i projektligjit që ndryshon nenin 3 të ligjit “Përkufizime” është riformuluar nga grupi i punës dhe ndryshimet janë miratuar nga Komisioni i Ligjeve. Ndryshimet në përmbajtjen e nenit 4 të projektligjit janë bazuar në rekomandimet e ekspertëve të OSBE. Konkretisht,

- Akronimi “AMA” për Autoritetin e Mediave Audiovizive mbetet, por Autoriteti do të njihet si Autoriteti i Mediave Shqiptare.

Mosndryshimi i akronimit u diskutua në komision dhe u vendos si i tillë me argumentin se mund të krijojë probleme në raport me komunikimet me të tretët, sidomos jashtë vendit.

- Në pikën 22, gërma “c” togflalëshi “*media elektronike*” zëvendësohet me togflalëshin “*publikimeve elektronike*”.

Ky ndryshim u propozua nga eksperti i OSBE-së.

- Përmbajtja e pikës 26/1 riformulohet me këtë përmbajtje:
“Publikimi elektronik”, nënkupton faqe interneti me përmbajtje të formësuar editoriale dhe/ose portale që përmbajnë versione elektronike të medias së shkruar dhe/ose informacione mediatike të ofruara për publikun, me qëllim argëtimin, informimin dhe edukimin. Publikimet elektronike të bëra nga individë, të cilat nuk kanë përmbajtje të formësuar editoriale dhe nuk kanë qëllim edukimin, argëtimin, apo informimin për publikun, nuk konsiderohen publikime elektronike në kuptim të këtij ligji.

Ky ndryshim u propozua nga eksperti i OSBE-së.

a) Përmbajtja e pikës 7 riformulohet si më poshtë vijon:

Pas pikës 53 shtohen pikat 54 dhe 55, me këtë përmbajtje:

“54. “Regjistri i Ofruesve të Shërbimeve Mediatike”, është një regjistër kombëtar ku regjistrohen ofruesit e shërbimeve audio, audiovizive dhe ofruesit e shërbimit të publikimeve elektronike.

Pika 55 e këtij neni sipas projektligjit, që jep përkufizimin e medias outlet, hiqet, bazuar në propozimin e ekspertit të OSBE-së.

Pika 56 këtij neni të projektligjit bëhet pika 55.

Ky ndryshim u propozua nga eksperti i OSBE-së.

Neni 6 i projektligjit që shton një nen të ri, nenin 4/1 të titulluar “Interpretimi i ligjit”, pika 2, me propozim të grupit të punës, togfjalëshi “Ky ligj duhet të interpretohet...” zëvendësohet me togfjalëshin “Ky ligj interpretohet dhe zbatohet”

Neni 7 i projektligjit që ndryshon titullin ndryshon “Autoriteti i Mediave Shqiptare (AMA)”.

Ky ndryshim është bërë bazuar në propozimin e ekspertit të OSBE-së.

Neni 8, paragrafi 1 i projektligjit është riformuluar nga grupi i punës dhe diskutimet në komision.

Bazuar në diskutimet e përfaqësuesve të AMA-s në komision, pika 1 e këtij neni mbetet sikurse është në ligjin në fuqi duke shtuar, bazuar në propozimin e ekspertit të OSBE-së një paragraf të ri me përmbajtjen:

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Organet vendimmarrëse të AMA-s janë Bordi dhe Këshilli i Ankesave”.

Pas nenit 8 shtohen **4 nene të reja** me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Neni 9

Kudo në tekstin e këtij ligji bëhen këto ndryshime:

- 1. Fjalët “Kryetari i AMA-s” dhe “Kryetarit të AMA-s” zëvendësohen me fjalët “Kryetari i Bordit të AMA-s” dhe “Kryetarit të Bordit të AMA-s”;*
- 2. Fjalët “Zëvendëskryetari i AMA-s” zëvendësohet me fjalët “Zëvendëskryetari i Bordit të AMA-s”;*
- 3. Fjalët “anëtarët e AMA-s” dhe “anëtari i AMA-s” zëvendësohen me fjalët “anëtarët e Bordit të AMA-s” dhe “anëtari i Bordit të AMA-s”.*

Neni 10

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

- 1. Titulli i nenit 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Përbërja e Bordit të AMA-s”*

Neni 11

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

- 1. Titulli i nenit 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Zgjedhja e anëtarëve të bordit të AMA-s”;*
- 2. Në nenin 9, kudo në tekst, para fjalëve “AMA-s”, të vendosen fjalët “Bordit të”.*

Neni 12

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:

- 1. Titulli i nenit 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Kuoromi dhe vendimarrja e Bordit të AMA-s”*
- 2. Në nenin 13 kudo në tekst, fjalët “mbledhjet e AMA-s” dhe “vendimet e AMA-s” zëvendësohen me fjalët “mbledhjet e Bordit të AMA-s” dhe “vendimet e Bordit të AMA-s”.*

Këto nene janë shtuar bazuar në propozimet e ekspertëve të OSBE-së.

Neni 9 i projektligjit që ndryshon nenin 18 të ligjit në fuqi ka ndryshuar bazuar në propozimet e ekspertëve të OSBE-së.

Në nenin 18 të ligjit në fuqi bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Fjalja hyrëse e nënit të projektligjit riformulohet si më poshtë:

- 1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime dhe shtesat e mëposhtme:*

b) Pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e”, me këtë përmbajtje:

“e) nxitjen e përmbajtjes së përgjegjshme në publikimet elektronike dhe nxitjen e respektimit të një Kodi Etike ndërmjet operatorëve dhe ofruesve të këtyre shërbimeve në këtë drejtim.”.

Neni 10 i projektligjit që bën shtesa dhe ndryshime në nenin 19 të ligjit në fuqi është riformular nga grupi i punës, bazuar në diskutimet e bëra në seanca dëgjimore dhe

propozimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, propozimeve të përfaqësuesit të Ministrisë së Drejtësisë i cili propozoi nevojën e unifikimit të termave si dhe bazuar në diskutimet e anëtarëve në komision.

Përmbajtja e gërmës “j” ndryshon si më poshtë vijon:

“j) bashkëpunimi dhe këshillimi me Autoritetin Kombëtar të Certifikimeve Elektronike dhe Sigurinë Kompjuterike (AKCESK), AKEP-in, Autoritetin e Konkurrencës, autoritetin përgjegjës për mbrojtjen nga diskriminimi, autoritetin përgjegjës për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të si dhe organet e tjera në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj;”.

Neni 11 i projektligjit, që ndryshon nenin 20 të ligjit në fuqi, është diskutuar gjerësisht dhe projekti i propozuar nga Këshilli i Ministrave është riformuluar duke reflektuar propozimet e ekspertëve të OSBE-së dhe propozimin e grupit të punës që procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të këtij këshilli të bazohet në rregullat e konkurrueshmërisë.

Për të forcuar edhe më shumë pavarësinë e Këshillit të Ankesave, për herë të parë parashikohet që anëtarët e këshillit nuk caktohen, por përzgjidhen mes një procesi publik, transparent dhe konkurrueshmërisë.

Bazuar në diskutimet dhe sugjerimet e grupit të punës dhe ekspertëve të OSBE-së në nenin 20 të ligjit në fuqi, pika 1 e nenit riformulohet si më poshtë:

“1. Këshilli i Ankesave është organ kolegjal vendimmarrës, i cili përzgjidhet nga Bordi i AMA-s me shumicë të cilësuar dhe përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë, specialistë të fushës së medias, të cilët emërohen për një periudhë 3-vjeçare, me të drejtë riemërimi jo më shumë se një herë. Procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Ankesave, që bazohen në rregullat e konkurrueshmërisë, dhe rregullorja e organizimit dhe funksionimit të tij përcaktohen me vendim të Bordit të AMA-s”.

Propozohet nga ekspertët e OSBE-së shtimi i një pike pas pikës 3 me këtë përmbajtje:

“3/1. Vendimet e Këshillit të Ankesave sipas pikës 3/b të këtij neni ankimohen në Bordin e AMA-s.”.

Në nenin 12 të projektligjit që ndryshon, që shton shkronjat “e” dhe “ë” në neni 21 të ligjit në fuqi është propozuar ndryshimi i përmbajtjes së shkronjës “e” dhe “ë” me përmbajtjen si më poshtë vijon:

Pas shkronjës “dh”, të pikës 2, të nenit 21, shtohen shkronjat “e” dhe “ë”, me këtë përmbajtje:

“e) të marrë masa dhe veprime për të nxitur lirinë e medias në përputhje me rregullat dhe detyrimet etike.

ë) të nxisë vetërregullimin e medias.”.

Përmbajtja e pikës 2 të nenit 13 të projektligjit që ndryshon pikën 4 të nenit 22 të ligjit në fuqi ndryshon

Në nenin 22 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

2. Në pikën 4, fjalët “... transmetimet audio dhe/ose audiovizive ...” zëvendësohen me “... shërbimet e medias elektronike ...”.

Në nenin 15 të projektligjit që ndryshon nenin 30 të ligjit në fuqi, janë bërë përmirësime të teknikës legislative sipas përmbajtjes bashkëlidhur në tekstin integral.

Në nenin 16 të projektligjit që ndryshon nenin 31 të ligjit në fuqi bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Titulli i nenit 31 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Llojet e ofruesve të shërbimeve të medias elektronike”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Në përputhje me mënyrën e komunikimit me publikun e gjerë, ofruesit e shërbimeve të medias së shkruar janë, si më poshtë vijon:

a) Shtypi i shkruar;

b) Publikimet elektronike.”.

Në nenin 18 të projektligjit që shton nenet e reja 33/1 dhe 33/2, konkretisht në pikën 1 të nenit 33/1, me propozim të anëtarëve të komisionit, shtohen fjalitë si më poshtë vijon:

“Institucionet përgjegjëse njoftojnë AMA-n lidhur me procesin e rregjistrimit të ofruesve të shërbimit të mediave elektronike. AMA pasqyron të dhënat në rregjistrin e ofruesve të shërbimit të mediave elektronike.”

Me propozim të ekspertëve të OSBE-së hiqet paragrafi 2 i nenit 18 të projektligjit. Gjithashtu në pikën 4 hiqen togfjalëshat “besimit politik” dhe “anëtarësimi në sindikata”.

Me propozim të grupit të punës në nenin 33/2, në titull hiqet fjala “identifikim” dhe në fjalinë e fundit fjala “identifikim” zëvendësohet me “regjistrim”.

Në nenin 19 të projektligjit që shton një nen të ri, nenin 37/1, pika 3 riformulohet bazuar në diskutimet nga grupi i punës dhe diskutimet në komision si më poshtë vijon:

“3. Pas mbarimit të afatit të parashikuar në licencën apo autorizimin e lëshuar, AMA kryesisht ose me kërkesë nga subjekti i interesuar fshin nga regjistri ofruesin e shërbimeve të medias elektronike dhe njofton autoritetet përgjegjëse të cilat kanë informuar AMA-n lidhur me këtë subjekt.”

Anëtarët e Komisionit propozojnë **shtimin e një neni të ri që ndryshon pikën 15 të nenit 53 me këtë përmbajtje:**

“15. Vendimi i AMA-s mund të kundërshtohet në Gjykatën Administrative, Tiranë.”

Në nenin 23 të projektligjit që parashikon shtimin e nenit 53/1 u miratuan këto ndryshime:

Në paragrafin 1 hiqet fjala “dinjiteti”, propozim i ekspertëve të OSBE-së

Kudo në tekst fjala “prekur” zëvendësohet me “cënuar”.

Me propozim të grupit të punës dhe anëtarëve të komisionit në paragrafin 1 dhe 3 togfjalëshi *“informacioneve jo të sakta”* zëvendësohet me *“informacioneve të pavërteta dhe/ose të pasakta”*.

Në shkronjën “c” të pikës 6 fjala *“e vërteta”* zëvendësohet me *“direkte”*, propozim i grupit të punës

Në shkronjën “b” të pikës 9 togfjalëshi *“për ndonjë fakt apo fakti në vetvete”* zëvendësohet me *“me karakter fakti ose informacioni”*, propozim i ekspertëve të OSBE-së.

Në shkronjën “e” të pikës 9 fjala *“publikimi”* zëvendësohet me *“përmbajtja e publikimit”*, propozim i ekspertëve të OSBE-së.

Propozohet gjithashtu nga ekspertët e OSBE-së shtimi i pikës 10 me këtë përmbajtje:
“10. Kundër vendimit të AMA-s bëhet ankim në Gjykatën Administrative, Tiranë.”

Neni 24 i projektligjit që ndryshon nenin 132 të ligjit në fuqi me propozim të ekspertëve të OSBE-së, grupit të punës dhe pas diskutimeve në mbledhjen e komisionit riformulohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:

Neni 132 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 132

Masat për shkeljet

1. Në rastet e shkeljes së dispozitave të këtij ligji, në përputhje me procedurat dhe parashikimet e këtij ligji dhe akteve nënligjore të tij, pas marrjes së mendimeve të organeve përgjegjëse, nëse parashikohen, AMA (Bordi dhe/ose KA) vendos:

a) detyrimin e ofruesit të shërbimit të medias:

i. për të publikuar formulën e korrigjimit sipas formës dhe përmbajtjes së parashikuar në nenin 53/1 të këtij ligji;

ii. për të kërkuar nëpërmjet AKEP-it vendosjen e një njoftimi të karakterizuar teknikisht si “pop up”;

b) për të vendosur gjobë, shuma e së cilës përcaktohet në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të tij;

c) për të vendosur pezullim të përkohshëm të licencës dhe/ose autorizimit;

ç) për të vendosur uljen e kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës dhe/ose autorizimit;

d) për të vendosur heqje të licencës dhe/ose autorizimit.

2. AMA në vendimin e saj merr në konsideratë masën dhe kohëzgjatjen e shkeljes së kryer sipas rregullave të përcaktuara në shkronjën “k” të paragrafit 1 të nenit 19 të këtij ligji.

3. AMA vendos sanksione të parashikuara në këtë ligj jo më vonë se një vit nga data e kryerjes së shkeljes.

4. Kur AMA vëren shkelje të dispozitave ligjore, për të cilat me ligj vendosin sanksione organet e tjera shtetërore, atëherë ajo njofton këto të fundit.

5. Për shkelje të kryera nga OSHPE-të, për përmbajtjen e publikimeve elektronike, në bazë të një vendimi të marrë nga AMA, në vijim të procedurës së parashikuar në këtë ligj dhe pas marrjes së mendimit me shkrim nga AKCESK-u, Autoriteti i Komunikimit Elektronike dhe Postar (AKEP):

a) të urdhërojnë heqjen e përmbajtjes së caktuar menjëherë, por jo më vonë se 60 minuta nga njoftimi në rastet kur shërbimet e medias elektronike dyshohet se mund të nxisin kryerjen e një nga veprave penale në vijim:

i. pornografi me fëmijë;

ii. inkurajimin e akteve terroriste;

iii. shkelje të sigurisë kombëtare.

Në rast të moszbatimit të urdhrit brenda afatit të përcaktuar, të bllokojë aksesin në internet.

b) të vendosë një njoftim “pop up” në faqen e internetit/domain-in e portalit i cili përmban informacion mbi vendimet e organeve vendimmarrëse të AMA-s. Në marrjen e vendimit sipas shkronjës “a”, të kësaj pike, AMA pasi dëgjon ofruesin e shërbimit të publikimeve elektronike dhe nëse është e mundur autorin e përmbajtjes së publikuar, vlerëson shkeljen e kryer në raport me cënimin e së drejtës së lirisë së shprehjes në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

6. Kundër vendimit të bllokimit të aksesit në internet subjekti ka të drejtë të bëjë ankim pranë AMA-s brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit, sipas pikës 3, të këtij neni. AMA shqyrton ankesën dhe shpall vendimin jo më vonë se 10 ditë. Kundër vendimit të AMA-s mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative, Tiranë.

7. Vendimet e AMA-s ekzekutohen nga shërbimi përmbarimor, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. AMA nuk ka detyrim të parapaguajë taksën apo tarifën për shërbimin përmbarimor.

8. Kundër vendimit të KA-së së AMA-s mund të bëhet ankim sipas dispozitave të pikës 6 të këtij neni. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të Këshillit të Ankesave.

9. Vendimet e KA-së së AMA-s do të ekzekutohen nga Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. AMA nuk ka detyrim të parapaguajë tarifën ose tarifën për shërbimin përmbarimor.”.

Neni 25 i projektligjit që shton nenin 132/1 është hequr bazuar në propozimin e ekspertëve të OSBE-së.

Neni 26 i projektligjit që ndryshon nenin 133 të ligjit në fuqi ka pësuar ndryshime në disa pika. Konkretisht, në nenin që ndryshon nenin 133 të ligjit u miratuan ndryshimet e mëposhtme:

Shkronja “b” e pikës 2 me propozim të ekspertëve të OSBE-së ndryshon si më poshtë:

“b) në masën nga 40 000 deri në 800 000 lekë, kur nuk respekton vendimin e Këshillit të Ankesave ose të drejtën e përgjigjes, sipas nenit 53/1, të këtij ligji.”

Në pikën 3 hiqet shkronja “b”, propozuar nga përfaqësuesit e AKEP-it.

Shtohet pika 5 me propozim të ekspertëve të OSBE-së me këtë përmbajtje:

5. Në fund të fjalisë së dytë, të pikës 11, shtohen fjalët, si më poshtë:

“....sipas parashikimeve të nenit 19, të këtij ligji, bazuar në parimin e proporcionalitetit.”.

Në projektligjin e depozituar nga Këshilli i Ministrave janë bërë edhe redaktime të teknikës legjislativë

VII. PËRFUNDIME

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

- a) *Në aspektin ligjor*, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- b) *Në aspektin procedural*, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e shumicës së anëtarëve të komisionit e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare sipas tekstit integral bashkëlidhur këtij raporti, e cila i përcillet komisionit përgjegjës.

RELATORE

KRYETARI

VASILIKA HYSI

ULSI MANJA

KLOTÏLDA BUSHKA (FERHATÏ)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2019

PËR
DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.97/2013, “PËR MEDIAT
AUDIOVIZIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Titulli i ligjit ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Për shërbimet e medias në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2

Neni 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 1
Objekti

Ky ligj rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave fizikë dhe juridikë, që ofrojnë shërbime audio, audiovizive dhe shërbime të publikimeve elektronike, nëpërmjet rrjetit të komunikimeve elektronike, si dhe promovimin e pluralizmit të medias dhe çështjeve të tjera me rëndësi për shërbimet mediatike, në përputhje me konventat dhe standardet ndërkombëtare.”.

Neni 3

Neni 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare, shërbimet mbështetëse të tyre dhe për shërbimet e publikimeve elektronike. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar.”.

Neni 4

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 3, emërtimi “Autoriteti i Mediave Audiovizive” zëvendësohet me “Autoriteti i Mediave Shqiptare”.

2. Pas pikës 17 shtohet pika 17/1, me këtë përmbajtje:

“17/1. Ofruesi i Shërbimit të Publikimeve Elektronike (OSHPE) është personi fizik ose juridik, pavarësisht nëse është i regjistruar ose jo si i tillë në Regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve Mediatike, i cili ofron shërbimet e publikimeve elektronike, siç janë përcaktuar në pikën 26/1 të këtij neni.”.

3. Pika 22 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“22. “Përgjegjësi editoriale”, nënkupton ushtrimin e kontrollit efektiv si për përzgjedhjen e programeve dhe për organizimin e tyre në:

- a) një listë dhe orar, në rastin e shërbimeve të transmetimit të drejtpërdrejtë audioviziv;
- b) një katalog, në rastin e shërbimeve të programit audioviziv, sipas kërkesës;
- c) një publikim në rastin e publikimeve elektronike.”.

4. Pika 23 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“23. “Prodhime të pavarura”, nënkuptojnë aktivitetet e prodhimit të veprave mediatike, të cilat plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:

a) Kur nuk janë të kontrolluara ose të lidhura me transmetuesit me licencë ose me autorizim për transmetim ose me ofruesit e shërbimeve të regjistruara në Regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve Mediatike;

b) Kur për një periudhë prej tri vitesh, të paktën 90 për qind e këtyre prodhimeve nuk janë të destinuara për një transmetues të vetëm.”.

5. Pika 24 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“24. “Prodhues i pavarur”, është personi fizik a juridik, i regjistruar për prodhimin e veprave audio dhe audiovizive me vendndodhje në Republikën e Shqipërisë ose në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian, ose në ndonjë vend tjetër, që është nënshkruar i një marrëveshjeje ndërkombëtare të detyrueshme për zbatim për Republikën e Shqipërisë, që nuk është i lidhur me një ofrues të shërbimit të medias, pjesëmarrës në treg, në kuptim të ligjit që rregullon mbrojtjen e konkurrencës.

24/1. “Prodhimi personal”, është një program ose publikim që është prodhuar për herë të parë nga ofruesi i shërbimit të medias ose një person tjetër nën drejtimin dhe në emër të ofruesit të shërbimit të medias.

24/2. “Bashkëprodhimi”, është një prodhim ose publikim i përbashkët i ofruesve të shërbimeve mediatike ose ofruesit të shërbimit mediatik dhe një prodhuesi të pavarur.”.

6. Pas pikës 26 shtohen pikat 26/1 dhe 26/2, me këtë përmbajtje:

“26/1. “Publikimi elektronik”, nënkupton faqe interneti me përmbajtje të formësuar editoriale dhe/ose portale që përmbajnë versione elektronike të medias së shkruar dhe/ose informacione mediatike të ofruara për publikun, me qëllim argëtimin, informimin dhe edukimin. Publikimet elektronike të bëra nga individë, të cilat nuk kanë përmbajtje të formësuar editoriale dhe nuk kanë qëllim edukimin, argëtimin, apo informimin për publikun, nuk konsiderohen publikime elektronike në kuptim të këtij ligji.

26/2. “Media elektronike”, është program ose përmbajtje programi audio dhe audioviziv, përmbajtje programi e ofruar për publikun, nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit dhe përmbajtje e publikimeve elektronike.”.

7. Pas pikës 53 shtohen pikat 54 dhe 55, me këtë përmbajtje:

“54. “Regjistri i Ofruesve të Shërbimeve Mediatike”, është një regjistër kombëtar ku regjistrohen ofruesit e shërbimeve audio, audiovizive dhe ofruesit e publikimeve elektronike.

55. “Përmbajtje e programit”, janë informacionet, idetë, shprehje mendimesh si dhe vepra të autorësisë në formë audio (në vijim referuar si përmbajtje audio), ose në formën e imazheve të lëvizshme, me ose pa tinguj (në vijim referuar si përmbajtje audiovizive) që përbën një element individual brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, i cili bëhet i disponueshëm për publikun përmes mediave elektronike me qëllim për të informuar, argëtuar, edukuar.”.

Neni 5

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Parimet themelore të veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve mediatike”.

2. Në pikën 2, të nenit 4, fjala “... audioviziv ...” zëvendësohet me fjalët “... të medias elektronike ...”.

Neni 6

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1.

Interpretimi i ligjit

1. Dispozitat e këtij ligji nuk mund të interpretohen në mënyrë të tillë që të japin të drejtën për të censuruar apo kufizuar të drejtën për lirinë e fjalës ose lirinë e shprehjes.

2. Ky ligj interpretohet dhe zbatohet në përputhje me parimet e Konventës Evropiane për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, sikurse zbatohet në praktikatat ligjore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”.

Neni 7

Titulli i kreut II ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Autoriteti i Mediave Shqiptare (AMA)”.

Neni 8

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive, shërbimeve të tjera mbështetëse të tyre si dhe shërbimeve të medias elektronike në territorin e Republikës së Shqipërisë.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Organet vendimmarrëse të AMA-s janë Bordi dhe Këshilli i Ankesave.”.

Neni 9

Kudo në tekstin e këtij ligji bëhen këto ndryshime:

1. Fjalët “Kryetari i AMA-s” dhe “Kryetarit të AMA-s” zëvendësohen me fjalët “Kryetari i Bordit të AMA-s” dhe “Kryetarit të Bordit të AMA-s”;

2. Fjalët “Zëvendëskryetari i AMA-s” zëvendësohet me fjalët “Zëvendëskryetari i Bordit të AMA-s”;

3. Fjalët “anëtarët e AMA-s” dhe “anëtari i AMA-s” zëvendësohen me fjalët “anëtarët e Bordit të AMA-s” dhe “anëtari i Bordit të AMA-s”.

Neni 10

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Përbërja e Bordit të AMA-s”

Neni 11

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Zgjedhja e anëtarëve të bordit të AMA-s”;
2. Në nenin 9, kudo në tekst, para fjalëve “AMA-s”, të vendosen fjalët “Bordit të” .

Neni 12

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Kuoromi dhe vendimmarrja e Bordit të AMA-s”
2. Në nenin 13 kudo në tekst, fjalët “mbledhjet e AMA-s” dhe “vendimet e AMA-s” zëvendësohen me fjalët “mbledhjet e Bordit të AMA-s” dhe “vendimet e Bordit të AMA-s”.

Neni 13

Në nenin 18 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime dhe shtesat e mëposhtme:
 - a) Në shkronjën “a”, fjala “... audiovizive ...” zëvendësohet me fjalët “... mediatike, të cilat janë në fushën e veprimit të këtij ligji ...”.
 - b) Në shkronjën “c”, pas fjalës “... shërbimeve ...” shtohen fjalët “... mediatike, të cilat janë në fushën e veprimit të këtij ligji ...”.
2. Në pikën 2 bëhen shtesat, me këtë përmbajtje:
 - a) Në shkronjën “a”, pas fjalës “... programeve ...” shtohen fjalët “... dhe publikimeve ...”.
 - b) Pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e”, me këtë përmbajtje:
“e) nxitjen e përmbajtjes së përgjegjshme në publikimet elektronike dhe nxitjen e zbatimit të një Kodi Etike ndërmjet operatorëve dhe ofruesve të këtyre shërbimeve në këtë drejtim.”.

Neni 14

Në nenin 19 bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:
 - a) Shkronja “h” ndryshohet, si më poshtë vijon:
“h) zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet ofruesve të shërbimeve të transmetimeve audio ose audiovizive, përfshirë mosmarrëveshjet me transmetuesin publik dhe mosmarrëveshjet ndërmjet subjekteve fizike/juridike dhe ofruesve të shërbimeve mediatike;”.
 - b) Shkronja “j” ndryshohet, si më poshtë vijon:
“j) bashkëpunimi dhe këshillimi me Autoritetin Kombëtar të Certifikimeve Elektronike dhe Sigurinë Kompjuterike (AKCESK), AKEP-in, Autoritetin e Konkurrencës, autoritetin përgjegjës për mbrojtjen nga diskriminimi, autoritetin përgjegjës për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të

fëmijëve, autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të si dhe organet e tjera në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj;”.

c) Pas shkronjës “j” shtohen shkronjat “k” dhe “l”, me këtë përmbajtje:

“k) miraton rregulloren e organizimit dhe të funksionimit të Këshillit të Ankesave (në vijim referuar si KA), ku përcaktohen rregulla specifike për trajtimin e ankesave të parashtruara pranë KA-së së bashku me përcaktimin e kritereve të qarta për zbatueshmërinë e sanksioneve të parashikuara nga ky ligj, me qëllim respektimin e parimit të proporcionalitetit.

l) administron dhe përditëson Regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve Mediatike;”.

2. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën “a”, fjalët “... mediave audiovizive ...” zëvendësohen me fjalën “ ... transmentimit ...”.

b) Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) mbikëqyr zhvillimin e veprimtarisë së medias elektronike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;”.

c) Në shkronjën “c”, fjalët “... mediave audiovizive ...” zëvendësohen me fjalën “ ... medias elektronike...”.

ç) Në shkronjën “ç”, fjalët “... mediave audiovizive, ...” zëvendësohen me “... mediave elektronike ...”.

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. AMA mbikëqyr zbatimin e këtij ligji nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e mediave elektronike dhe, në rast shkeljesh, vendos sanksione.”.

4. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. AMA jep mendim për veprimtarinë e medias elektronike në përgjithësi, dhe në mënyrë të veçantë për perspektivën e veprimtarisë së mediave audiovizive, sipas kërkesës, apo kryesisht.”.

5. Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. AMA merr pjesë në veprimtari ndërkombëtare, në lidhje me strategjinë dhe perspektivat e zhvillimit të mediave audiovizive në veçanti dhe shërbimeve të medias elektronike në përgjithësi, duke përfaqësuar Republikën e Shqipërisë dhe mbështet pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e subjekteve, publike e private, me organizata homologe evropiane dhe botërore. AMA përgatit studime me rekomandime për qëndrimin e Republikës së Shqipërisë në bisedimet ndërkombëtare zyrtare mbi median elektronike.”.

Neni 15

Në nenin 20 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Këshilli i Ankesave është organ kolegjal vendimmarrës, i cili përzgjidhet nga Bordi i AMA-s me shumicë të cilësuar dhe përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë, specialistë të fushës së medias, të cilët emërohen për një periudhë 3-vjeçare, me të drejtë riemërimi jo më shumë se një herë. Procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Ankesave, që bazohen në rregullat e konkurueshmërisë, dhe rregullorja e organizimit dhe funksionimit të tij përcaktohen me vendim të Bordit të AMA-s”.

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Objekti i punës së Këshillit të Ankesave është mbikëqyrja e zbatimit të parashikimeve të këtij ligji, atyre të Kodit dhe rregulloreve të miratuara nga AMA, që kanë të bëjnë me respektimin e dinjitetit dhe të të drejtave themelore të njeriut.”.

3. Në pikën 3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në shkronjën “a”, pas fjalës “... OSHMA-të...” shtohet “... OSHPE-të ...”.

b) Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) të shqyrtojë ankesat sipas neneve 51, 51/1, 52, 53 dhe 53/1, të këtij ligji.”.

4. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Vendimet e Këshillit të Ankesave sipas pikës 3/b të këtij neni ankimohen në Bordin e AMA-s.”.

Neni 16

Pas shkronjës “dh”, të pikës 2, të nenit 21, shtohen shkronjat “e” dhe “ë”, me këtë përmbajtje: “e) të marrë masa dhe veprime për të nxitur lirinë e medias në përputhje me rregullat dhe detyrimet etike.

ë) të nxisë vetërregullimin e medias.”.

Neni 17

Në nenin 22 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 2, pas fjalëve “... transmetimi audioviziv ...” shtohen “... së bashku me publikimin elektronik ...”.

2. Në pikën 4, fjalët “... transmetimet audio dhe/ose audiovizive ...” zëvendësohen me “... shërbimet e medias elektronike ...”.

Neni 18

Në pikën 1, të nenit 23, pas shkronjës “ç” shtohen shkronjat “d” dhe “dh”, me këtë përmbajtje:

“d) mbikëqyr zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e këtij ligji.

dh) mban dhe publikon Regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve të Medias Elektronike.”.

Neni 19

Neni 30 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 30

Ofruesit e shërbimeve mediatike në juridiksionin e Republikës së Shqipërisë

1. Ofruesi i shërbimit të medias që është nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë është i detyruar të respektojë rregullat që zbatohen për shërbimet e medias në Republikën e Shqipërisë.

2. Ofruesi i shërbimit të medias konsiderohet nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë nëse:

a) është themeluar në Republikën e Shqipërisë;

b) nuk është themeluar në Republikën e Shqipërisë, por:

i. përdor një stacion transmetimi satelitor tokësor që ndodhet në Republikën e Shqipërisë; dhe/ose

ii. përdor kapacitetin satelitor që i përket Republikës së Shqipërisë;

iii. përdor *domain*-et e administruara nga AKEP-i.

3. Ofruesi i shërbimit të medias konsiderohet, gjithashtu, nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë nëse:

a) zyra ose struktura e saj e menaxhimit është në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe vendimmarrja editoriale realizohet brenda këtij territori;

b) zyra ose struktura e saj e menaxhimit është në territorin e Republikës së Shqipërisë, por vendimmarrja editoriale për shërbimet e medias bëhet në një vend të BE-së, konsiderohet se

ofruesi i shërbimit të medias është nën jurisdiksionin e Republikës së Shqipërisë, me kusht që pjesa më e madhe e personelit të angazhuar në aktivitetet e shërbimeve mediatike të operojë në Shqipëri;

c) një pjesë e konsiderueshme e stafit të angazhuar në aktivitetet e shërbimeve të medias vepron në Republikën e Shqipërisë dhe në një vend të BE-së, ofruesi i shërbimit të medias konsiderohet të jetë i vendosur në Republikën e Shqipërisë, nëse selia e tij ndodhet në Republikën e Shqipërisë;

ç) një pjesë e konsiderueshme e personelit në aktivitetet e shërbimeve mediatike nuk operon as në Shqipëri as në një shtet anëtar të BE-së, ofruesi i shërbimit të medias konsiderohet të jetë i vendosur në Republikën e Shqipërisë, nëse aktiviteti i tij filloi për të parën herë në këtë vend, në përputhje me legjislacionin shqiptar, me kusht që ai të mbajë marrëdhënie të qëndrueshme dhe efikase me ekonominë shqiptare;

d) interesat e saj fitimprurëse kryesore lidhen me subjektet tregtare të themeluara sipas ligjit shqiptar ose që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

dh) mbi 50% e përdoruesve/ndjekësve/abonentëve janë rezidentë të Republikës së Shqipërisë;

e) komunikimi/publikimi i tij i parë ndaj publikut të gjerë po bëhet në Shqipëri/për Shqipërinë.

4. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për ato shërbime të medias që, edhe pse nuk përfshihen në pikat 2 e 3, të këtij neni:

a) përdorin një lidhje satelitore nga territori i Republikës së Shqipërisë;

b) nuk përdorin lidhje satelitore nga territori i Republikës së Shqipërisë, por përdorin hapësirën transmetuese satelitore dhe burimet që i përkasin Republikës së Shqipërisë.

5. Kur një ofrues i shërbimit të medias elektronike ka selinë në Republikën e Shqipërisë, por vendimet për shërbimet e kësaj media bëhen në një vend të tretë ose anasjelltas, ofruesi konsiderohet të jetë i vendosur në Republikën e Shqipërisë, me kusht që shumica e stafit/fuqisë punëtore të angazhuar në aktivitetet e shërbimeve të medias funksionon në Republikën e Shqipërisë.

6. Nëse juridiksioni nuk mund të përcaktohet sipas pikave 2 deri 6, të këtij neni, shteti anëtar kompetent është ai në të cilin ndodhet OSHMA-ja, në kuptim të neneve 49 dhe 50, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së e shteteve anëtare të saj.

7. Në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, çështja e juridiksionit, në përputhje me pikën 6, të këtij neni, do të zgjidhet në përputhje me nenet 49 deri 55, të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian.”.

Neni 20

Në nenin 31 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i nenit 31 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Llojet e ofruesve të shërbimeve mediatike”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Në përputhje me mënyrën e komunikimit me publikun e gjerë, ofruesit e shërbimeve të medias së shkruar janë, si më poshtë vijon:

a) Shtypi i shkruar;

b) Publikimet elektronike.”.

Neni 21

Në shkronjën “ë”, të pikës 1, të nenit 33, pas fjalëve “... të drejtat e autorit ...” shtohen fjalët “... transmetimit, ritransmetimit ...”.

Neni 22

Pas nenit 33 shtohen nenet 33/1 dhe 33/2, me këtë përmbajtje:

“Neni 33/1

Detyrimet e OSHPE-ve

1. Ofruesi i shërbimit të publikimit elektronik duhet të bëjë lehtësisht të aksesueshëm, në mënyrë direkte dhe të përhershme për publikun e gjerë, të paktën, informacionin e mëposhtëm:

a) Emrin e ofruesit të shërbimit;

b) Vendndodhjen e zyrave qendrore ose vendqëndrimin e ofruesit të shërbimit, adresën e tij elektronike ose atë të faqes së internetit;

c) Organin kompetent të ofruesit të shërbimit.

Institucionet përgjegjëse njoftojnë AMA-n lidhur me procesin e regjistrimit të ofruesve të shërbimit të mediave elektronike. AMA pasqyron të dhënat në regjistrin e ofruesve të shërbimit të mediave elektronike.

2. Një ofrues i shërbimeve të publikimeve elektronike duhet të publikojë paralajmërim të përshtatshëm për përmbajtjen e publikimeve, të cilat mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, shëndetësor, moral, mendor, intelektual, emocional dhe social të të miturve.

3. E drejta e korrigjimit dhe e përgjigjes ndaj informacionit të publikuar, nëpërmjet një ofruesi të shërbimeve të publikimeve elektronike, do të ushtrohet në përputhje me ligjin që rregullon mediat.

4. Ofruesi i shërbimit të publikimeve elektronike nuk duhet të nxisë, të shtojë nxitjen ose të përhapë urrejtje apo diskriminim në bazë të racës, prejardhjes etnike, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare ose sociale, gjendjes financiare, arsimit, statusit social, gjendjes martesore ose familjare, moshës, gjendjes shëndetësore, paaftësisë, trashëgimisë gjenetike, identitetit gjinor apo orientimit seksual.

5. Publikimi i informacionit që zbulon identitetin e të miturit nën moshën 18 vjeç, i përfshirë në çdo rast të dhunës, pa marrë parasysh nëse është dëshmitar, viktimë apo shkelës, ose zbulimin e ndonjë veçantie të marrëdhënieve familjare dhe jetës private të një fëmije, ndalohet.

Neni 33/2

Regjistrimi i ofruesve të shërbimit të publikimeve elektronike

Një person fizik a juridik, i cili ofron shërbime të publikimeve elektronike, do të aplikojë tek AMA për regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave të tij në Regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve Mediatike. Ky regjistrim nuk është parakusht për të ofruar shërbimin.”.

Neni 23

Pas nenit 37 shtohet neni 37/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 37/1

Regjistri i ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike

1. AMA mban, administron dhe publikon një regjistër të ofruesve të shërbimit të medias, të licencuar, të autorizuar ose jo.

2. Përmbajtja e aplikimit të referuar në nenin 33\2 dhe mënyra e mbajtjes së regjistrit të përditësuar miratohen nga AMA. Regjistri sipas pikës 1, të këtij neni, përmban, në veçanti:

- a) emrin e shërbimeve të medias;
 - b) emrin e ofruesit të shërbimit të medias dhe informacion për shërbimin e ofruar;
 - c) numrin dhe datën e lëshimit të licencës, arsyet për ofrimin e shërbimeve nëse ofrohet pa asnjë detyrim për të marrë autorizim ose licencë;
 - ç) llojin e shërbimeve të medias, në përputhje me këtë ligj;
 - d) periudhën për të cilën lëshohet autorizimi apo licenca;
 - dh) të dhëna për personin përgjegjës të ofruesit të shërbimit të medias elektronike;
 - e) informacion rreth masave të vendosura ndaj ofruesit të shërbimit të medias elektronike.
3. Pas mbarimit të afatit të parashikuar në licencën apo autorizimin e lëshuar, AMA kryesisht ose me kërkesë nga subjekti i interesuar fshin nga regjistri ofruesin e shërbimeve të medias elektronike dhe njofton autoritetet përgjegjëse të cilat kanë informuar AMA-n lidhur me këtë subjekt.
4. Ofruesit e shërbimeve të medias elektronike, që nuk janë regjistruar në këtë regjistrë ose që nuk i kanë përditësuar të dhënat në përputhje me rregullat e përcaktuara nga AMA, nuk përfitojnë lehtësira fiskale apo të ndonjë lloji tjetër.”.

Neni 24

Pas pikës 6, të nenit 42, shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Të gjitha format e komunikimeve me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive dhe publikimet elektronike për lojërat e fatit, bastet sportive, kazinotë dhe bingot televizive, janë të ndaluara.”.

Neni 25

Pas nenit 51 shtohet neni 51/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 51/1

Procedurat për trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave

1. OSHPE-ja ka detyrimin të shqyrtojë çdo ankesë të arsyetuar të paraqitur me shkrim nga çdo person për programet e publikuara prej tij, lidhur me zbatimin e kërkesave të nenit 33/1, të këtij ligji.
2. Ankesa i paraqitet OSHPE-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e publikimit/transmetimit të përmbajtjes, ose në rastin e dy ose më shumë publikimeve të lidhura me njëra-tjetrën, nga data e publikimit/transmetimit më të fundit.
3. Personi që pretendon shkeljen, ka të drejtë t’i kërkojë ofruesit të shërbimit të publikimit elektronik, duke paraqitur arsyet dhe faktet që mbështesin kërkesën, heqjen e përmbajtjes.
4. Ofruesi i shërbimit të publikimit elektronik, brenda 72 orësh nga marrja e ankesës, shqyrton ankesën dhe informon ankuesin.
5. Nëse OSHPE-ja refuzon ankesën ose nuk kthen përgjigje brenda 72 orësh nga marrja e saj, personi ka të drejtë të ankohet pranë Këshillit të Ankesave. Këshilli i Ankesave, brenda 72 orësh nga depozitimi/paraqitja e ankesës, vendos mbi ankesën përkatëse ose nga paraqitja e pretendimeve të OSHPE-së në rastet e zbatimit të pikës 6, të këtij neni.
6. Këshilli i Ankesave, kur e çmon të nevojshme, ia kalon ankesën e paraqitur OSHPE-së për të paraqitur pretendimet e veta brenda 48 orësh.
7. Pas shqyrtimit të ankesës dhe/ose pretendimeve të OSHPE-së, Këshilli i Ankesave, nëse çmon se ka shkelje, merr masat përkatëse, duke përfshirë sanksionet në përputhje me këtë ligj. Në çdo rast, Këshilli i Ankesave njofton me shkrim personin që ka paraqitur ankesën dhe OSHPE-në përkatëse mbi konkluzionet dhe masat.

8. OSHPE-ja publikon konkluzionin e Këshillit të Ankesave, kur ky konkluzion është në favor të personit që ka kryer ankesën, brenda 48 orësh nga marrja e njoftimit, në mënyrë të njëjtë me atë të publikimit, kundrejt të cilit është bërë ankesa.”.

Neni 26

Në nenin 52 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3, numri “ ... 7 ... ” zëvendësohet me “ ... 3 ...”.
2. Në pikën 6, pas fjalëve “... periudhë sa më të shkurtër ...” shtohen fjalët “ ... por jo më vonë se 5 ditë ...”.

Neni 27

Në nenin 53, pika 15 ndryshon si më poshtë vijon:

“15. Vendimi i AMA-s mund të kundërshtohet në Gjykatën Administrative, Tiranë.

Neni 28

Pas nenit 53 shtohet neni 53/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 53/1

E drejta e përgjigjes për OSHPE-të

1. Çdo person, reputacioni i të cilit është cënuar drejtpërdrejt nga publikimi i fakteve dhe informacioneve të pavërteta dhe/ose të pasakta prej OSHPE-së, ka të drejtën e përgjigjes.
2. Personi, që ka të drejtën e përgjigjes, duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim, drejtuar ofruesit të shërbimit të publikimit elektronik duke parashtruar arsyet dhe faktet që mbështetin kërkesën e tij.
3. Kërkesa për të drejtën e përgjigjes duhet të paraqitet tek OSHPE-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i fakteve dhe informacioneve që pretendohen të pavërteta dhe/ose të pasakta.
4. Brenda 48 orëve nga marrja e kërkesës, OSHPE-ja vendos për ushtrimin ose refuzimin e së drejtës së përgjigjes dhe për këtë njofton me shkrim kërkuuesin.
5. Ofruesi i shërbimeve të publikimeve elektronike, nëse vendos për ushtrimin e së drejtës, publikon përgjigjen e çdo personi që është cënuar/përmendur nga publikimi, pa kosto financiare për personin e cënuar/përmendur. Përgjigjja duhet të publikohet e plotë, e dukshme dhe në të njëjtën faqe ku është publikuar materiali që kontestohet. Nëse publikimi hiqet nga faqja/portali përpara se përgjigjja e personit të cënuar/përmendur të publikohet, përgjigjja duhet të jetë e vendosur në një pozicion të krahasueshëm dhe për të njëjtën kohëzgjatje si publikimi i mëparshëm.
6. Ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike nuk kanë detyrim të publikojnë përgjigjen siç parashikohet në pikën 1, të këtij neni, nëse:
 - a) pala e cënuar/përmendur nuk ka interes të ligjshëm për të dhënë përgjigje;
 - b) përgjigjja në mënyrë të papërshtatshme tejkalon shkallën e pohimit të fakteve që kontestohen;
 - c) përgjigjja nuk kufizohet vetëm në informacion faktik ose përfshin përmbajtje që kanë të bëjnë me ndjekjen e një procedure penale.Ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike nuk kanë detyrim të publikojnë përgjigjen për lajmin/informacionin e kontestuar në lidhje me raportimet direkte në sesionet e hapura të organeve të Kuvendit dhe organeve të tjera shtetërore.

7. Nëse kërkuesi nuk merr një përgjigje brenda afatit të përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, prezumohet se OSHPE-ja ka refuzuar kërkesën.

8. Këshilli i Ankesave, brenda 72 orësh nga paraqitja e një ankese për refuzimin e së drejtës së përgjigjes nga një OSHPE, shqyrton çështjen dhe, nëse e gjen të drejtë ankesën e bërë, i kërkon OSHPE-së, korrigjimin e fakteve dhe informacioneve, në lidhje me personin e interesuar, në një mënyrë të ngjashme dhe kohë të njëjtë me atë të publikimit, objekt ankese, brenda 48 orëve nga marrja e njoftimit:

a) në fillim të procedurës së shqyrtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave i kërkon OSHPE-së, të cilit i adresohet ankesa, dhënien e shpjegimeve në lidhje me këtë ankesë.

b) Këshilli i Ankesave i dërgon ankuesit dhe OSHPE-së përkatëse konkluzionet e arsyetuara për rastin.

9. Këshilli i Ankesave mund të refuzojë një ankesë kur:

a) vlerëson se ajo është abuzive dhe e pabazuar apo e bërë në keqbesim;

b) e drejta e kërkuar për përgjigje është opinion personal i personit dhe nuk ka të bëjë me rregullimin e ndonjë lajmi me karakter fakti apo informacioni;

c) e drejta e kërkuar për përgjigje përmban parashtrimin e fakteve dhe informacioneve të rreme;

ç) e drejta e kërkuar për përgjigje është bërë për të kërkuar parandalimin e veprimeve të pritshme apo që nuk kanë ndodhur ende;

d) përmbushja e së drejtës për përgjigje përfshin një ndëshkim, kapërcen rregullat e mirësjelljes apo sjell dënimin e ofruesit të shërbimit mediatik në një proces gjyqësor civil;

dh) personi i dëmtuar nga informacioni i kundërshtuar nuk ka interes të ligjshëm në momentin e kërkesës për ushtrimin e së drejtës së përgjigjes;

e) përmbajtja e publikimit të kundërshtuar përmban thënie apo deklarime të personit të cënuar, që konsiderohen të barasvlershme me vetë përgjigjen e kërkuar ose kur personi ka dhënë pëlqimin paraprak në një mënyrë formale lidhur me përmbajtjen e publikimit;

ë) një korrigjim i barasvlershëm i të dhënave të informacionit të kundërshtuar është bërë paraprakisht dhe për këtë është njoftuar personi i cënuar;

f) përmbajtja e përgjigjes së kërkuar dhunon të drejtat e një pale të tretë;

g) çështja objekt ankese lidhet me thëniet gjatë veprimtarive parlamentare, zhvillimit të seancave gjyqësore apo transmetimit të veprimtarive të subjekteve politike;

gj) publikimi i së drejtës për përgjigje nuk është në interes të publikut;

h) kërkesa është paraqitur në tejkalim të afatit.

10. Kundër vendimit të AMA-s bëhet ankim në Gjykatën Administrative, Tiranë.

Neni 29

Neni 132 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 132

Masat për shkeljet

1. Në rastet e shkeljes së dispozitave të këtij ligji, në përputhje me procedurat dhe parashikimet e këtij ligji dhe akteve nënligjore të tij, pas marrjes së mendimeve të organeve përgjegjëse, nëse parashikohen, AMA (Bordi dhe/ose KA) vendos:

a) detyrimin e ofruesit të shërbimit të medias:

i. për të publikuar formulën e korrigjimit sipas formës dhe përmbajtjes së parashikuar në nenin 53/1 të këtij ligji;

ii. për të kërkuar nëpërmjet AKEP-it vendosjen e një njoftimi të karakterizuar teknikisht si “pop up”;

b) për të vendosur gjobë, shuma e së cilës përcaktohet në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të tij;

c) për të vendosur pezullim të përkohshëm të licencës dhe/ose autorizimit;

- ç) për të vendosur uljen e kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës dhe/ose autorizimit;
- d) për të vendosur heqje të licencës dhe/ose autorizimit.
2. AMA në vendimin e saj merr në konsideratë masën dhe kohëzgjatjen e shkeljes së kryer sipas rregullave të përcaktuara në shkronjën “k” të paragrafit 1 të nenit 19 të këtij ligji.
3. AMA vendos sanksione të parashikuara në këtë ligj jo më vonë se një vit nga data e kryerjes së shkeljes.
4. Kur AMA vëren shkelje të dispozitave ligjore, për të cilat me ligj vendosin sanksione organet e tjera shtetërore, atëherë ajo njofton këto të fundit.
5. Për shkelje të kryera nga OSHPE-të, për përmbajtjen e publikimeve elektronike, në bazë të një vendimi të marrë nga AMA, në vijim të procedurës së parashikuar në këtë ligj dhe pas marrjes së mendimit me shkrim nga AKCESK-u, Autoriteti i Komunikimit Elektronike dhe Postar (AKEP):
- a) të urdhërojë heqjen e përmbajtjes së caktuar menjëherë, por jo më vonë se 60 minuta nga njoftimi në rastet kur shërbimet e medias elektronike dyshohet se mund të nxisin kryerjen e një nga veprave penale në vijim:
- i. pornografi me fëmijë;
 - ii. inkurajimin e akteve terroriste;
 - iii. shkelje të sigurisë kombëtare.
- Në rast të moszbatimit të urdhrit brenda afatit të përcaktuar, të bllokojë aksesin në internet.
- b) të vendosë një njoftim “pop up” në faqen e internetit/domain-in e portalit i cili përmban informacion mbi vendimet e organeve vendimmarrëse të AMA-s. Në marrjen e vendimit sipas shkronjës “a”, të kësaj pike, AMA pasi dëgjon ofruesin e shërbimit të publikimeve elektronike dhe nëse është e mundur autorin e përmbajtjes së publikuar, vlerëson shkeljen e kryer në raport me cënimin e së drejtës së lirisë së shprehjes në përputhje me parimin e proporcionalitetit.
6. Kundër vendimit të bllokimit të aksesit në internet subjekti ka të drejtë të bëjë ankim pranë AMA-s brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit, sipas pikës 3, të këtij neni. AMA shqyrton ankesën dhe shpall vendimin jo më vonë se 10 ditë. Kundër vendimit të AMA-s mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative, Tiranë.
7. Vendimet e AMA-s ekzekutohen nga shërbimi përmbarimor, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. AMA nuk ka detyrim të parapaguajë taksën apo tarifën për shërbimin përmbarimor.
8. Kundër vendimit të KA-së së AMA-s mund të bëhet ankim sipas dispozitave të pikës 6 të këtij neni. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të Këshillit të Ankesave.
9. Vendimet e KA-së së AMA-s do të ekzekutohen nga Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. AMA nuk ka detyrim të parapaguajë tarifën ose tarifën për shërbimin përmbarimor.”.

Neni 30

Në nenin 133 bëhen këto ndryshime:

1. Fjalja e parë ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Shkeljet e mëposhtme, të kryera nga OSHMA-ja dhe OSHPE-ja, kur ato nuk përbëjnë vepër penale përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen, si më poshtë:”.
2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“1. Me gjobë:
a) nga 100 000 deri 1 000 000 lekë, në rastet kur:
i. nuk respekton detyrimet që rrjedhin nga nenet 33 dhe 33/1, të këtij ligji;
ii. nuk zbaton afatin e ruajtjes së regjistrimit të transmetimeve, sipas përcaktimeve të nenit 37, të këtij ligji.

b) në masën nga 40 000 deri në 800 000 lekë, kur nuk respekton vendimin e Këshillit të Ankesave ose të drejtën e përgjigjes, sipas nenit 53/1, të këtij ligji.

Përsëritja e shkeljes më shumë se 3 herë gjatë një viti dënohet me një rritje deri në 50% të shumës së gjobës të përmendur më lart. Në rast përsëritjeje më shumë se 5 herë gjatë vitit të kaluar, subjekti nuk do të përfitojë lehtësira fiskale apo të ndonjë lloji tjetër për një periudhë 3-vjeçare.”.

3. Në pikën 2, shkronja “a” ndryshon si më poshtë vijon:

“a) Në fjalinë e parë, numri “... 120 000 ...” zëvendësohet me “... 800 000 ...”.

4. Në pikën 10, përpara fjalës “... inspektorët ...” shtohen fjalët “... Këshilli i Ankesave ...”.

5. Në fund të fjalisë së dytë, të pikës 11, shtohen fjalët, si më poshtë:

“....sipas parashikimeve të nenit 19, të këtij ligji, bazuar në parimin e proporcionalitetit.”.

Neni 31

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2019

PËR
DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.97/2013, “PËR MEDIAT
AUDIOVIZIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Titulli i ligjit ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Për shërbimet e medias në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2

Neni 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 1
Objekti

Ky ligj rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave fizikë dhe juridikë, që ofrojnë shërbime audio, audiovizive dhe shërbime të publikimeve elektronike, nëpërmjet rrjetit të komunikimeve elektronike, si dhe promovimin e pluralizmit të medias dhe çështjeve të tjera me rëndësi për shërbimet mediatike, në përputhje me konventat dhe standardet ndërkombëtare.”.

Neni 3

Neni 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare, shërbimet mbështetëse të tyre dhe për shërbimet e publikimeve elektronike. Ky ligj nuk zbatohet për shtypin e shkruar.”.

Neni 4

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 3, emërtimi “Autoriteti i Mediave Audiovizive” zëvendësohet me “Autoriteti i Mediave Shqiptare”.

2. Pas pikës 17 shtohet pika 17/1, me këtë përmbajtje:

“17/1. Ofruesi i Shërbimit të Publikimeve Elektronike (OSHPE) është personi fizik ose juridik, pavarësisht nëse është i regjistruar ose jo si i tillë në Regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve Mediatike, i cili ofron shërbimet e publikimeve elektronike, siç janë përcaktuar në pikën 26/1 të këtij neni.”.

3. Pika 22 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“22. “Përgjegjësi editoriale”, nënkupton ushtrimin e kontrollit efektiv si për përzgjedhjen e programeve dhe për organizimin e tyre në:

- a) një listë dhe orar, në rastin e shërbimeve të transmetimit të drejtpërdrejtë audioviziv;
- b) një katalog, në rastin e shërbimeve të programit audioviziv, sipas kërkesës;
- c) një publikim në rastin e publikimeve elektronike.”.

4. Pika 23 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“23. “Prodhime të pavarura”, nënkuptojnë aktivitetet e prodhimit të veprave mediatike, të cilat plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:

a) Kur nuk janë të kontrolluara ose të lidhura me transmetuesit me licencë ose me autorizim për transmetim ose me ofruesit e shërbimeve të regjistruara në Regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve Mediatike;

b) Kur për një periudhë prej tri vitesh, të paktën 90 për qind e këtyre prodhimeve nuk janë të destinuara për një transmetues të vetëm.”.

5. Pika 24 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“24. “Prodhues i pavarur”, është personi fizik a juridik, i regjistruar për prodhimin e veprave audio dhe audiovizive me vendndodhje në Republikën e Shqipërisë ose në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian, ose në ndonjë vend tjetër, që është nënshkruar i një marrëveshjeje ndërkombëtare të detyrueshme për zbatim për Republikën e Shqipërisë, që nuk është i lidhur me një ofrues të shërbimit të medias, pjesëmarrës në treg, në kuptim të ligjit që rregullon mbrojtjen e konkurrencës.

24/1. “Prodhimi personal”, është një program ose publikim që është prodhuar për herë të parë nga ofruesi i shërbimit të medias ose një person tjetër nën drejtimin dhe në emër të ofruesit të shërbimit të medias.

24/2. “Bashkëprodhimi”, është një prodhim ose publikim i përbashkët i ofruesve të shërbimeve mediatike ose ofruesit të shërbimit mediatik dhe një prodhuesi të pavarur.”.

6. Pas pikës 26 shtohen pikat 26/1 dhe 26/2, me këtë përmbajtje:

“26/1. “Publikimi elektronik”, nënkupton faqe interneti me përmbajtje të formësuar editoriale dhe/ose portale që përmbajnë versione elektronike të medias së shkruar dhe/ose informacione mediatike të ofruara për publikun, me qëllim argëtimin, informimin dhe edukimin. Publikimet elektronike të bëra nga individë, të cilat nuk kanë përmbajtje të formësuar editoriale dhe nuk kanë qëllim edukimin, argëtimin, apo informimin për publikun, nuk konsiderohen publikime elektronike në kuptim të këtij ligji.

26/2. “Media elektronike”, është program ose përmbajtje programi audio dhe audioviziv, përmbajtje programi e ofruar për publikun, nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit dhe përmbajtje e publikimeve elektronike.”.

7. Pas pikës 53 shtohen pikat 54 dhe 55, me këtë përmbajtje:

“54. “Regjistri i Ofruesve të Shërbimeve Mediatike”, është një regjistër kombëtar ku regjistrohen ofruesit e shërbimeve audio, audiovizive dhe ofruesit e publikimeve elektronike.

55. “Përmbajtje e programit”, janë informacionet, idetë, shprehje mendimesh si dhe vepra të autorësisë në formë audio (në vijim referuar si përmbajtje audio), ose në formën e imazheve të lëvizshme, me ose pa tinguj (në vijim referuar si përmbajtje audiovizive) që përbën një element individual brenda një liste apo katalogu të krijuar nga ofruesi i shërbimit, i cili bëhet i disponueshëm për publikun përmes mediave elektronike me qëllim për të informuar, argëtuar, edukuar.”.

Neni 5

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Parimet themelore të veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve mediatike”.

2. Në pikën 2, të nenit 4, fjala “... audioviziv ...” zëvendësohet me fjalët “... të medias elektronike ...”.

Neni 6

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1.

Interpretimi i ligjit

1. Dispozitat e këtij ligji nuk mund të interpretohen në mënyrë të tillë që të japin të drejtën për të censuruar apo kufizuar të drejtën për lirinë e fjalës ose lirinë e shprehjes.

2. Ky ligj interpretohet dhe zbatohet në përputhje me parimet e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, sikurse zbatohet në praktikën ligjore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”.

Neni 7

Titulli i kreut II ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Autoriteti i Mediave Shqiptare (AMA)”.

Neni 8

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive, shërbimeve të tjera mbështetëse të tyre si dhe shërbimeve të medias elektronike në territorin e Republikës së Shqipërisë.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Organet vendimmarrëse të AMA-s janë Bordi dhe Këshilli i Ankesave.”.

Neni 9

Kudo në tekstin e këtij ligji bëhen këto ndryshime:

1. Fjalët “Kryetari i AMA-s” dhe “Kryetari të AMA-s” zëvendësohen me fjalët “Kryetari i Bordit të AMA-s” dhe “Kryetari të Bordit të AMA-s”;

2. Fjalët “Zëvendëskryetari i AMA-s” zëvendësohet me fjalët “Zëvendëskryetari i Bordit të AMA-s”;

3. Fjalët “anëtarët e AMA-s” dhe “anëtari i AMA-s” zëvendësohen me fjalët “anëtarët e Bordit të AMA-s” dhe “anëtari i Bordit të AMA-s”.

Neni 10

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Përbërja e Bordit të AMA-s”

Neni 11

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Zgjedhja e anëtarëve të bordit të AMA-s”;
2. Në nenin 9, kudo në tekst, para fjalëve “AMA-s”, të vendosen fjalët “Bordit të” .

Neni 12

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Kuoromi dhe vendimmarrja e Bordit të AMA-s”
2. Në nenin 13 kudo në tekst, fjalët “mbledhjet e AMA-s” dhe “vendimet e AMA-s” zëvendësohen me fjalët “mbledhjet e Bordit të AMA-s” dhe “vendimet e Bordit të AMA-s”.

Neni 13

Në nenin 18 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime dhe shtesat e mëposhtme:
 - a) Në shkronjën “a”, fjala “... audiovizive ...” zëvendësohet me fjalët “... mediatike, të cilat janë në fushën e veprimit të këtij ligji ...”.
 - b) Në shkronjën “c”, pas fjalës “... shërbimeve ...” shtohen fjalët “... mediatike, të cilat janë në fushën e veprimit të këtij ligji ...”.
2. Në pikën 2 bëhen shtesat, me këtë përmbajtje:
 - a) Në shkronjën “a”, pas fjalës “... programeve ...” shtohen fjalët “... dhe publikimeve ...”.
 - b) Pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e”, me këtë përmbajtje:
“e) nxitjen e përmbajtjes së përgjegjshme në publikimet elektronike dhe nxitjen e zbatimit të një Kodi Etike ndërmjet operatorëve dhe ofruesve të këtyre shërbimeve në këtë drejtim.”.

Neni 14

Në nenin 19 bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:
 - a) Shkronja “h” ndryshohet, si më poshtë vijon:
“h) zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet ofruesve të shërbimeve të transmetimeve audio ose audiovizive, përfshirë mosmarrëveshjet me transmetuesin publik dhe mosmarrëveshjet ndërmjet subjekteve fizike/juridike dhe ofruesve të shërbimeve mediatike;”.
 - b) Shkronja “j” ndryshohet, si më poshtë vijon:
“j) bashkëpunimi dhe këshillimi me Autoritetin Kombëtar të Certifikimeve Elektronike dhe Sigurinë Kompjuterike (AKCESK), AKEP-in, Autoritetin e Konkurrencës, autoritetin përgjegjës për mbrojtjen nga diskriminimi, autoritetin përgjegjës për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të

fëmijëve, autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të si dhe organet e tjera në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj;”.

c) Pas shkronjës “j” shtohen shkronjat “k” dhe “l”, me këtë përmbajtje:

“k) miraton rregulloren e organizimit dhe të funksionimit të Këshillit të Ankesave (në vijim referuar si KA), ku përcaktohen rregulla specifike për trajtimin e ankesave të parashtruara pranë KA-së së bashku me përcaktimin e kritereve të qarta për zbatueshmërinë e sanksioneve të parashikuara nga ky ligj, me qëllim respektimin e parimit të proporcionalitetit.

l) administron dhe përditëson Regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve Mediatike;”.

2. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën “a”, fjalët “... mediave audiovizive ...” zëvendësohen me fjalën “ ... transmentimit ...”.

b) Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) mbikëqyr zhvillimin e veprimtarisë së medias elektronike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;”.

c) Në shkronjën “c”, fjalët “... mediave audiovizive ...” zëvendësohen me fjalën “ ... medias elektronike...”.

ç) Në shkronjën “ç”, fjalët “... mediave audiovizive, ...” zëvendësohen me “... mediave elektronike ...”.

3. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. AMA mbikëqyr zbatimin e këtij ligji nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e mediave elektronike dhe, në rast shkeljesh, vendos sanksione.”.

4. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. AMA jep mendim për veprimtarinë e medias elektronike në përgjithësi, dhe në mënyrë të veçantë për perspektivën e veprimtarisë së mediave audiovizive, sipas kërkesës, apo kryesisht.”.

5. Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. AMA merr pjesë në veprimtari ndërkombëtare, në lidhje me strategjinë dhe perspektivat e zhvillimit të mediave audiovizive në veçanti dhe shërbimeve të medias elektronike në përgjithësi, duke përfaqësuar Republikën e Shqipërisë dhe mbështet pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin e subjekteve, publike e private, me organizata homologe evropiane dhe botërore. AMA përgatit studime me rekomandime për qëndrimin e Republikës së Shqipërisë në bisedimet ndërkombëtare zyrtare mbi median elektronike.”.

Neni 15

Në nenin 20 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1, ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Këshilli i Ankesave është organ kolegjal vendimmarrës, i cili përzgjidhet nga Bordi i AMA-s me shumicë të cilësuar dhe përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë, specialistë të fushës së medias, të cilët emërohen për një periudhë 3-vjeçare, me të drejtë riemërimi jo më shumë se një herë. Procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Ankesave, që bazohen në rregullat e konkurueshmërisë, dhe rregullorja e organizimit dhe funksionimit të tij përcaktohen me vendim të Bordit të AMA-s”.

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Objekti i punës së Këshillit të Ankesave është mbikëqyrja e zbatimit të parashikimeve të këtij ligji, atyre të Kodit dhe rregulloreve të miratuara nga AMA, që kanë të bëjnë me respektimin e dinjitetit dhe të të drejtave themelore të njeriut.”.

3. Në pikën 3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në shkronjën “a”, pas fjalës “... OSHMA-të...” shtohet “... OSHPE-të ...”.

b) Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) të shqyrtojë ankesat sipas neneve 51, 51/1, 52, 53 dhe 53/1, të këtij ligji.”.

4. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Vendimet e Këshillit të Ankesave sipas pikës 3/b të këtij neni ankimohen në Bordin e AMA-s.”.

Neni 16

Pas shkronjës “dh”, të pikës 2, të nenit 21, shtohen shkronjat “e” dhe “ë”, me këtë përmbajtje: “e) të marrë masa dhe veprime për të nxitur lirinë e medias në përputhje me rregullat dhe detyrimet etike.

ë) të nxisë vetërregullimin e medias.”.

Neni 17

Në nenin 22 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 2, pas fjalëve “... transmetimi audioviziv ...” shtohen “... së bashku me publikimin elektronik ...”.

2. Në pikën 4, fjalët “... transmetimet audio dhe/ose audiovizive ...” zëvendësohen me “... shërbimet e medias elektronike ...”.

Neni 18

Në pikën 1, të nenit 23, pas shkronjës “ç” shtohen shkronjat “d” dhe “dh”, me këtë përmbajtje:

“d) mbikëqyr zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e këtij ligji.

dh) mban dhe publikon Regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve të Medias Elektronike.”.

Neni 19

Neni 30 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 30

Ofruesit e shërbimeve mediatike në juridiksionin e Republikës së Shqipërisë

1. Ofruesi i shërbimit të medias që është nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë është i detyruar të respektojë rregullat që zbatohen për shërbimet e medias në Republikën e Shqipërisë.

2. Ofruesi i shërbimit të medias konsiderohet nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë nëse:

a) është themeluar në Republikën e Shqipërisë;

b) nuk është themeluar në Republikën e Shqipërisë, por:

i. përdor një stacion transmetimi satelitor tokësor që ndodhet në Republikën e Shqipërisë; dhe/ose

ii. përdor kapacitetin satelitor që i përket Republikës së Shqipërisë;

iii. përdor *domain*-et e administruara nga AKEP-i.

3. Ofruesi i shërbimit të medias konsiderohet, gjithashtu, nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë nëse:

a) zyra ose struktura e saj e menaxhimit është në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe vendimmarrja editoriale realizohet brenda këtij territori;

b) zyra ose struktura e saj e menaxhimit është në territorin e Republikës së Shqipërisë, por vendimmarrja editoriale për shërbimet e medias bëhet në një vend të BE-së, konsiderohet se

ofruesi i shërbimit të medias është nën jurisdiksionin e Republikës së Shqipërisë, me kusht që pjesa më e madhe e personelit të angazhuar në aktivitetet e shërbimeve mediatike të operojë në Shqipëri;

c) një pjesë e konsiderueshme e stafit të angazhuar në aktivitetet e shërbimeve të medias vepron në Republikën e Shqipërisë dhe në një vend të BE-së, ofruesi i shërbimit të medias konsiderohet të jetë i vendosur në Republikën e Shqipërisë, nëse selia e tij ndodhet në Republikën e Shqipërisë;

ç) një pjesë e konsiderueshme e personelit në aktivitetet e shërbimeve mediatike nuk operon as në Shqipëri as në një shtet anëtar të BE-së, ofruesi i shërbimit të medias konsiderohet të jetë i vendosur në Republikën e Shqipërisë, nëse aktiviteti i tij filloi për të parën herë në këtë vend, në përputhje me legjislacionin shqiptar, me kusht që ai të mbajë marrëdhënie të qëndrueshme dhe efikase me ekonominë shqiptare;

d) interesat e saj fitimprurëse kryesore lidhen me subjektet tregtare të themeluara sipas ligjit shqiptar ose që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

dh) mbi 50% e përdoruesve/ndjekësve/abonentëve janë rezidentë të Republikës së Shqipërisë;

e) komunikimi/publikimi i tij i parë ndaj publikut të gjerë po bëhet në Shqipëri/për Shqipërinë.

4. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për ato shërbime të medias që, edhe pse nuk përfshihen në pikat 2 e 3, të këtij neni:

a) përdorin një lidhje satelitore nga territori i Republikës së Shqipërisë;

b) nuk përdorin lidhje satelitore nga territori i Republikës së Shqipërisë, por përdorin hapësirën transmetuese satelitore dhe burimet që i përkasin Republikës së Shqipërisë.

5. Kur një ofrues i shërbimit të medias elektronike ka selinë në Republikën e Shqipërisë, por vendimet për shërbimet e kësaj media bëhen në një vend të tretë ose anasjelltas, ofruesi konsiderohet të jetë i vendosur në Republikën e Shqipërisë, me kusht që shumica e stafit/fuqisë punëtore të angazhuar në aktivitetet e shërbimeve të medias funksionon në Republikën e Shqipërisë.

6. Nëse juridiksioni nuk mund të përcaktohet sipas pikave 2 deri 6, të këtij neni, shteti anëtar kompetent është ai në të cilin ndodhet OSHMA-ja, në kuptim të neneve 49 dhe 50, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së e shteteve anëtare të saj.

7. Në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, çështja e juridiksionit, në përputhje me pikën 6, të këtij neni, do të zgjidhet në përputhje me nenet 49 deri 55, të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian.”.

Neni 20

Në nenin 31 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i nenit 31 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Llojet e ofruesve të shërbimeve mediatike”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Në përputhje me mënyrën e komunikimit me publikun e gjerë, ofruesit e shërbimeve të medias së shkruar janë, si më poshtë vijon:

a) Shtypi i shkruar;

b) Publikimet elektronike.”.

Neni 21

Në shkronjën “ë”, të pikës 1, të nenit 33, pas fjalëve “... të drejtat e autorit ...” shtohen fjalët “... transmetimit, ritransmetimit ...”.

Neni 22

Pas nenit 33 shtohen nenet 33/1 dhe 33/2, me këtë përmbajtje:

“Neni 33/1

Detyrimet e OSHPE-ve

1. Ofruesi i shërbimit të publikimit elektronik duhet të bëjë lehtësisht të aksesueshëm, në mënyrë direkte dhe të përhershme për publikun e gjerë, të paktën, informacionin e mëposhtëm:

a) Emrin e ofruesit të shërbimit;

b) Vendndodhjen e zyrave qendrore ose vendqëndrimin e ofruesit të shërbimit, adresën e tij elektronike ose atë të faqes së internetit;

c) Organin kompetent të ofruesit të shërbimit.

Institucionet përgjegjëse njoftojnë AMA-n lidhur me procesin e regjistrimit të ofruesve të shërbimit të mediave elektronike. AMA pasqyron të dhënat në regjistrin e ofruesve të shërbimit të mediave elektronike.

2. Një ofrues i shërbimeve të publikimeve elektronike duhet të publikojë paralajmërim të përshtatshëm për përmbajtjen e publikimeve, të cilat mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, shëndetësor, moral, mendor, intelektual, emocional dhe social të të miturve.

3. E drejta e korrigjimit dhe e përgjigjes ndaj informacionit të publikuar, nëpërmjet një ofruesi të shërbimeve të publikimeve elektronike, do të ushtrohet në përputhje me ligjin që rregullon mediat.

4. Ofruesi i shërbimit të publikimeve elektronike nuk duhet të nxisë, të shtojë nxitjen ose të përhapë urrejtje apo diskriminim në bazë të racës, prejardhjes etnike, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, gjuhës, fesë, prejardhjes kombëtare ose sociale, gjendjes financiare, arsimit, statusit social, gjendjes martesore ose familjare, moshës, gjendjes shëndetësore, paaftësisë, trashëgimisë gjenetike, identitetit gjinor apo orientimit seksual.

5. Publikimi i informacionit që zbulon identitetin e të miturit nën moshën 18 vjeç, i përfshirë në çdo rast të dhunës, pa marrë parasysh nëse është dëshmitar, viktimë apo shkelës, ose zbulimin e ndonjë veçantie të marrëdhënieve familjare dhe jetës private të një fëmije, ndalohet.

Neni 33/2

Regjistrimi i ofruesve të shërbimit të publikimeve elektronike

Një person fizik a juridik, i cili ofron shërbime të publikimeve elektronike, do të aplikojë tek AMA për regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave të tij në Regjistrin e Ofruesve të Shërbimeve Mediatike. Ky regjistrim nuk është parakusht për të ofruar shërbimin.”.

Neni 23

Pas nenit 37 shtohet neni 37/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 37/1

Regjistri i ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike

1. AMA mban, administron dhe publikon një regjistër të ofruesve të shërbimit të medias, të licencuar, të autorizuar ose jo.

2. Përmbajtja e aplikimit të referuar në nenin 33\2 dhe mënyra e mbajtjes së regjistrit të përditësuar miratohen nga AMA. Regjistri sipas pikës 1, të këtij neni, përmban, në veçanti:

- a) emrin e shërbimeve të medias;
 - b) emrin e ofruesit të shërbimit të medias dhe informacion për shërbimin e ofruar;
 - c) numrin dhe datën e lëshimit të licencës, arsyet për ofrimin e shërbimeve nëse ofrohet pa asnjë detyrim për të marrë autorizim ose licencë;
 - ç) llojin e shërbimeve të medias, në përputhje me këtë ligj;
 - d) periudhën për të cilën lëshohet autorizimi apo licenca;
 - dh) të dhëna për personin përgjegjës të ofruesit të shërbimit të medias elektronike;
 - e) informacion rreth masave të vendosura ndaj ofruesit të shërbimit të medias elektronike.
3. Pas mbarimit të afatit të parashikuar në licencën apo autorizimin e lëshuar, AMA kryesisht ose me kërkesë nga subjekti i interesuar fshin nga regjistri ofruesin e shërbimeve të medias elektronike dhe njofton autoritetet përgjegjëse të cilat kanë informuar AMA-n lidhur me këtë subjekt.
4. Ofruesit e shërbimeve të medias elektronike, që nuk janë regjistruar në këtë regjistrë ose që nuk i kanë përditësuar të dhënat në përputhje me rregullat e përcaktuara nga AMA, nuk përfitojnë lehtësira fiskale apo të ndonjë lloji tjetër.”.

Neni 24

Pas pikës 6, të nenit 42, shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. Të gjitha format e komunikimeve me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive dhe publikimet elektronike për lojërat e fatit, bastet sportive, kazinotë dhe bingot televizive, janë të ndaluara.”.

Neni 25

Pas nenit 51 shtohet neni 51/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 51/1

Procedurat për trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave

1. OSHPE-ja ka detyrimin të shqyrtojë çdo ankesë të arsyetuar të paraqitur me shkrim nga çdo person për programet e publikuara prej tij, lidhur me zbatimin e kërkesave të nenit 33/1, të këtij ligji.
2. Ankesa i paraqitet OSHPE-së jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e publikimit/transmetimit të përmbajtjes, ose në rastin e dy ose më shumë publikimeve të lidhura me njëra-tjetrën, nga data e publikimit/transmetimit më të fundit.
3. Personi që pretendon shkeljen, ka të drejtë t’i kërkojë ofruesit të shërbimit të publikimit elektronik, duke paraqitur arsyet dhe faktet që mbështesin kërkesën, heqjen e përmbajtjes.
4. Ofruesi i shërbimit të publikimit elektronik, brenda 72 orësh nga marrja e ankesës, shqyrton ankesën dhe informon ankuesin.
5. Nëse OSHPE-ja refuzon ankesën ose nuk kthen përgjigje brenda 72 orësh nga marrja e saj, personi ka të drejtë të ankohet pranë Këshillit të Ankesave. Këshilli i Ankesave, brenda 72 orësh nga depozitimi/paraqitja e ankesës, vendos mbi ankesën përkatëse ose nga paraqitja e pretendimeve të OSHPE-së në rastet e zbatimit të pikës 6, të këtij neni.
6. Këshilli i Ankesave, kur e çmon të nevojshme, ia kalon ankesën e paraqitur OSHPE-së për të paraqitur pretendimet e veta brenda 48 orësh.
7. Pas shqyrtimit të ankesës dhe/ose pretendimeve të OSHPE-së, Këshilli i Ankesave, nëse çmon se ka shkelje, merr masat përkatëse, duke përfshirë sanksionet në përputhje me këtë ligj. Në çdo rast, Këshilli i Ankesave njofton me shkrim personin që ka paraqitur ankesën dhe OSHPE-në përkatëse mbi konkluzionet dhe masat.

8. OSHPE-ja publikon konkluzionin e Këshillit të Ankesave, kur ky konkluzion është në favor të personit që ka kryer ankesën, brenda 48 orësh nga marrja e njoftimit, në mënyrë të njëjtë me atë të publikimit, kundrejt të cilit është bërë ankesa.”.

Neni 26

Në nenin 52 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 3, numri “ ... 7 ... ” zëvendësohet me “ ... 3 ... ”.
2. Në pikën 6, pas fjalëve “... periudhë sa më të shkurtër ...” shtohen fjalët “ ... por jo më vonë se 5 ditë ...”.

Neni 27

Në nenin 53, pika 15 ndryshon si më poshtë vijon:

“15. Vendimi i AMA-s mund të kundërshtohet në Gjykatën Administrative, Tiranë.

Neni 28

Pas nenit 53 shtohet neni 53/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 53/1

E drejta e përgjigjes për OSHPE-të

1. Çdo person, reputacioni i të cilit është çënuar drejtpërdrejt nga publikimi i fakteve dhe informacioneve të pavërteta dhe/ose të pasakta prej OSHPE-së, ka të drejtën e përgjigjes.
2. Personi, që ka të drejtën e përgjigjes, duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim, drejtuar ofruesit të shërbimit të publikimit elektronik duke parashtruar arsyet dhe faktet që mbështetin kërkesën e tij.
3. Kërkesa për të drejtën e përgjigjes duhet të paraqitet tek OSHPE-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i fakteve dhe informacioneve që pretendohen të pavërteta dhe/ose të pasakta.
4. Brenda 48 orëve nga marrja e kërkesës, OSHPE-ja vendos për ushtrimin ose refuzimin e së drejtës së përgjigjes dhe për këtë njofton me shkrim kërkuuesin.
5. Ofruesi i shërbimeve të publikimeve elektronike, nëse vendos për ushtrimin e së drejtës, publikon përgjigjen e çdo personi që është çënuar/përmendur nga publikimi, pa kosto financiare për personin e çënuar/përmendur. Përgjigjja duhet të publikohet e plotë, e dukshme dhe në të njëjtën faqe ku është publikuar materiali që kontestohet. Nëse publikimi hiqet nga faqja/portali përpara se përgjigjja e personit të çënuar/përmendur të publikohet, përgjigjja duhet të jetë e vendosur në një pozicion të krahasueshëm dhe për të njëjtën kohëzgjatje si publikimi i mëparshëm.
6. Ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike nuk kanë detyrim të publikojnë përgjigjen siç parashikohet në pikën 1, të këtij neni, nëse:
 - a) pala e çënuar/përmendur nuk ka interes të ligjshëm për të dhënë përgjigje;
 - b) përgjigjja në mënyrë të papërshtatshme tejkalon shkallën e pohimit të fakteve që kontestohen;
 - c) përgjigjja nuk kufizohet vetëm në informacion faktik ose përfshin përmbajtje që kanë të bëjnë me ndjekjen e një procedure penale.Ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike nuk kanë detyrim të publikojnë përgjigjen për lajmin/informacionin e kontestuar në lidhje me raportimet direkte në sesionet e hapura të organeve të Kuvendit dhe organeve të tjera shtetërore.

7. Nëse kërkuesi nuk merr një përgjigje brenda afatit të përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, prezumohet se OSHPE-ja ka refuzuar kërkesën.

8. Këshilli i Ankesave, brenda 72 orësh nga paraqitja e një ankese për refuzimin e së drejtës së përgjigjes nga një OSHPE, shqyrton çështjen dhe, nëse e gjen të drejtë ankesën e bërë, i kërkon OSHPE-së, korrigjimin e fakteve dhe informacioneve, në lidhje me personin e interesuar, në një mënyrë të ngjashme dhe kohë të njëjtë me atë të publikimit, objekt ankese, brenda 48 orëve nga marrja e njoftimit:

a) në fillim të procedurës së shqyrtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave i kërkon OSHPE-së, të cilit i adresohet ankesa, dhënien e shpjegimeve në lidhje me këtë ankesë.

b) Këshilli i Ankesave i dërgon ankuesit dhe OSHPE-së përkatëse konkluzionet e arsyetuara për rastin.

9. Këshilli i Ankesave mund të refuzojë një ankesë kur:

a) vlerëson se ajo është abuzive dhe e pabazuar apo e bërë në keqbesim;

b) e drejta e kërkuar për përgjigje është opinion personal i personit dhe nuk ka të bëjë me rregullimin e ndonjë lajmi me karakter fakti apo informacioni;

c) e drejta e kërkuar për përgjigje përmban parashtrimin e fakteve dhe informacioneve të rreme;

ç) e drejta e kërkuar për përgjigje është bërë për të kërkuar parandalimin e veprimeve të pritshme apo që nuk kanë ndodhur ende;

d) përmbushja e së drejtës për përgjigje përfshin një ndëshkim, kapërcen rregullat e mirësjelljes apo sjell dënimin e ofruesit të shërbimit mediatik në një proces gjyqësor civil;

dh) personi i dëmtuar nga informacioni i kundërshtuar nuk ka interes të ligjshëm në momentin e kërkesës për ushtrimin e së drejtës së përgjigjes;

e) përmbajtja e publikimit të kundërshtuar përmban thënie apo deklarime të personit të cënuar, që konsiderohen të barasvlershme me vetë përgjigjen e kërkuar ose kur personi ka dhënë pëlqimin paraprak në një mënyrë formale lidhur me përmbajtjen e publikimit;

ë) një korrigjim i barasvlershëm i të dhënave të informacionit të kundërshtuar është bërë paraprakisht dhe për këtë është njoftuar personi i cënuar;

f) përmbajtja e përgjigjes së kërkuar dhunon të drejtat e një pale të tretë;

g) çështja objekt ankese lidhet me thëniet gjatë veprimtarive parlamentare, zhvillimit të seancave gjyqësore apo transmetimit të veprimtarive të subjekteve politike;

gj) publikimi i së drejtës për përgjigje nuk është në interes të publikut;

h) kërkesa është paraqitur në tejkalim të afatit.

10. Kundër vendimit të AMA-s bëhet ankim në Gjykatën Administrative, Tiranë.

Neni 29

Neni 132 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 132

Masat për shkeljet

1. Në rastet e shkeljes së dispozitave të këtij ligji, në përputhje me procedurat dhe parashikimet e këtij ligji dhe akteve nënligjore të tij, pas marrjes së mendimeve të organeve përgjegjëse, nëse parashikohen, AMA (Bordi dhe/ose KA) vendos:

a) detyrimin e ofruesit të shërbimit të medias:

i. për të publikuar formulën e korrigjimit sipas formës dhe përmbajtjes së parashikuar në nenin 53/1 të këtij ligji;

ii. për të kërkuar nëpërmjet AKEP-it vendosjen e një njoftimi të karakterizuar teknikisht si “pop up”;

b) për të vendosur gjobë, shuma e së cilës përcaktohet në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të tij;

c) për të vendosur pezullim të përkohshëm të licencës dhe/ose autorizimit;

- ç) për të vendosur uljen e kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës dhe/ose autorizimit;
- d) për të vendosur heqje të licencës dhe/ose autorizimit.
2. AMA në vendimin e saj merr në konsideratë masën dhe kohëzgjatjen e shkeljes së kryer sipas rregullave të përcaktuara në shkronjën “k” të paragrafit 1 të nenit 19 të këtij ligji.
3. AMA vendos sanksione të parashikuara në këtë ligj jo më vonë se një vit nga data e kryerjes së shkeljes.
4. Kur AMA vëren shkelje të dispozitave ligjore, për të cilat me ligj vendosin sanksione organet e tjera shtetërore, atëherë ajo njofton këto të fundit.
5. Për shkelje të kryera nga OSHPE-të, për përmbajtjen e publikimeve elektronike, në bazë të një vendimi të marrë nga AMA, në vijim të procedurës së parashikuar në këtë ligj dhe pas marrjes së mendimit me shkrim nga AKCESK-u, Autoriteti i Komunikimit Elektronike dhe Postar (AKEP):
- a) të urdhërojë heqjen e përmbajtjes së caktuar menjëherë, por jo më vonë se 60 minuta nga njoftimi në rastet kur shërbimet e medias elektronike dyshohet se mund të nxisin kryerjen e një nga veprave penale në vijim:
- i. pornografi me fëmijë;
 - ii. inkurajimin e akteve terroriste;
 - iii. shkelje të sigurisë kombëtare.
- Në rast të moszbatimit të urdhrit brenda afatit të përcaktuar, të bllokojë aksesin në internet.
- b) të vendosë një njoftim “pop up” në faqen e internetit/domain-in e portalit i cili përmban informacion mbi vendimet e organeve vendimmarrëse të AMA-s. Në marrjen e vendimit sipas shkronjës “a”, të kësaj pike, AMA pasi dëgjon ofruesin e shërbimit të publikimeve elektronike dhe nëse është e mundur autorin e përmbajtjes së publikuar, vlerëson shkeljen e kryer në raport me cënimin e së drejtës së lirisë së shprehjes në përputhje me parimin e proporcionalitetit.
6. Kundër vendimit të bllokimit të aksesit në internet subjekti ka të drejtë të bëjë ankim pranë AMA-s brenda 30 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit, sipas pikës 3, të këtij neni. AMA shqyrton ankesën dhe shpall vendimin jo më vonë se 10 ditë. Kundër vendimit të AMA-s mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative, Tiranë.
7. Vendimet e AMA-s ekzekutohen nga shërbimi përmbarimor, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. AMA nuk ka detyrim të parapaguajë taksën apo tarifën për shërbimin përmbarimor.
8. Kundër vendimit të KA-së së AMA-s mund të bëhet ankim sipas dispozitave të pikës 6 të këtij neni. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të Këshillit të Ankesave.
9. Vendimet e KA-së së AMA-s do të ekzekutohen nga Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. AMA nuk ka detyrim të parapaguajë tarifën ose tarifën për shërbimin përmbarimor.”.

Neni 30

Në nenin 133 bëhen këto ndryshime:

1. Fjalja e parë ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Shkeljet e mëposhtme, të kryera nga OSHMA-ja dhe OSHPE-ja, kur ato nuk përbëjnë vepër penale përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen, si më poshtë:”.
2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“1. Me gjobë:
a) nga 100 000 deri 1 000 000 lekë, në rastet kur:
i. nuk respekton detyrimet që rrjedhin nga nenet 33 dhe 33/1, të këtij ligji;
ii. nuk zbaton afatin e ruajtjes së regjistrimit të transmetimeve, sipas përcaktimeve të nenit 37, të këtij ligji.

b) në masën nga 40 000 deri në 800 000 lekë, kur nuk respekton vendimin e Këshillit të Ankesave ose të drejtën e përgjigjes, sipas nenit 53/1, të këtij ligji.

Përsëritja e shkeljes më shumë se 3 herë gjatë një viti dënohet me një rritje deri në 50% të shumës së gjobës të përmendur më lart. Në rast përsëritjeje më shumë se 5 herë gjatë vitit të kaluar, subjekti nuk do të përfitojë lehtësira fiskale apo të ndonjë lloji tjetër për një periudhë 3-vjeçare.”.

3. Në pikën 2, shkronja “a” ndryshon si më poshtë vijon:

“a) Në fjalinë e parë, numri “... 120 000 ...” zëvendësohet me “... 800 000 ...”.

4. Në pikën 10, përpara fjalës “... inspektorët ...” shtohen fjalët “... Këshilli i Ankesave ...”.

5. Në fund të fjalisë së dytë, të pikës 11, shtohen fjalët, si më poshtë:

“....sipas parashikimeve të nenit 19, të këtij ligji, bazuar në parimin e proporcionalitetit.”.

Neni 31

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI